

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 2, datë 6.2.2025

PËR MIRATIMIN E LICENCËS STANDARDE TË RIPËRDORIMIT TË INFORMACIONIT TË SEKTORIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 11, pika 2 dhe nenit 22, pika 2, të ligjit nr. 33, datë 31.3.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”, ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

UDHËZOJNË:

I. QËLLIMI

1. Ky udhëzim ka për qëllim miratimin e licencës standarde për ripërdorimin e të dhënave të hapura në Republikën e Shqipërisë. Ripërdorimi i të dhënave të hapura/dokumenteve të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike si rregull është i hapur dhe vendosja e kushteve bëhet në rastet e justifikuara për interesin publik.

2. Qëllimi i licencës së të dhënave të hapura të organeve të sektorit publik dhe sipërmarrjeve publike, (në vijim “*licenca*”), për përdorimin e materialeve me të dhëna të hapura, është të ofrojë siguri juridike që të dhënat që janë objekt i licencës mund të përdoren lirisht nga të gjithë në çdo mënyrë të mundshme, me kushtin kryesor, që burimi i të dhënave, të përmendet në mënyrën që kërkohet në licencë.

3. Licenca standarde përcakton kushtet, të drejtat dhe kufizimet e ripërdorimit të të dhënave të hapura /dokumenteve për printimin, kopjimin, përpunimin e të dhënave, lejimin ose jo të transferimit të palët e treta, kërkesat për respektimin e pronësisë intelektuale, mbrojtjen e të dhënave personale për zbatimin e parashikimeve të ligjit nr. 33, datë 31.3.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

II. FUSHA E ZBATIMIT

Ky udhëzim zbatohet nga:

a) organet e sektorit publik, për ripërdorimin e dokumenteve ekzistuese që mbahen prej tyre, në kuadër të detyrës publike;

b) sipërmarrjet publike, për ripërdorimin e dokumenteve ekzistuese që mbahen prej tyre, në kuadër të shërbimeve që ato ofrojnë, për qëllime tregtare ose jo, të ndryshme nga qëllimi fillestar për të cilin dokumenti është krijuar.

III. MODELET E LICENCAVE PËR RIPËRDORIMIN E TË DHËNAVE TË HAPURA

1. Bazuar në praktikën dhe udhëzimet e Bashkimit Evropian, ripërdorimi i të dhënave të hapura do të bëhet me një nga licencat që i përkasin familjes së licencave Creative Commons (CC) (versioni 4.0), sipas aneksit 1 bashkëlidhur.

2. Licenca do të jetë në format elektronik dhe do të shoqërojë informacionin që do të publikohet nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al.

3. Licenca do të përzgjidhet nga organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike bazuar në veçoritë dhe specifikat e informacionit të prodhuar prej tyre, referuar legjisllacionit organik si dhe duke respektuar përcaktimet dhe kufizimet e ligjit nr. 33, datë 31.3.2022, “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”.

4. Kushtet e përdorimit duhet të jenë të lexueshme nga makineritë dhe ato duhet të jenë teknikisht të ndërveprueshme me licencat e tjera për përdorimin e materialeve të të dhënave publike.

5. Organet e sektorit publik dhe sipërmarrjet publike do të bashkëpunojnë me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit lidhur me implementimin e licencave në formatin elektronik, për dokumentet në formatin e të dhënave të hapura, në faqet e tyre zyrtare dhe në portalin opendata.gov.al, ripërdorimi i të cilave kërkon aplikimin e licencës standarde.

IV. INSTITUCIONET QË NGARKOHEN PËR MARRJEN E MASAVE DHE ZBATIMIN E KËTIJ UDHËZIMI

1. Autorizohet Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit të kontaktojë dhe bashkëpunojë me organizatën “creativecommons” me qëllim vendosjen e variantit shqip, sipas këtij udhëzimi, në faqen creativecommons.org për përdorimin e tyre nga Qeveria Shqiptare.





2. Ky udhëzim zbatohet nga organet e sektorit publik, sipërmarrjet publike në Republikën e Shqipërisë dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.




MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
Blendi Gonxhja





KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DHE MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
Besnik Dervishi

LEGJENDA SHPJEGUESE E LICENCAVE

LOGO	GRAFIKA	KUSHTET E RIPËRDORIMIT
	BY	Atributi duhet t'i jepet krijuesit.
	SA	Përshtatjet duhet të ndahen sipas të njëjtave kushte.
	NC	Lejohen vetëm përdorimet jokomerciale të veprës.
	ND	Nuk lejohet asnjë derivat apo përshtatje e veprës.

ANEKSI 1

Nr.	Emri i licencës	Përshkrimi	Elemente të licencës	Logo
Licenca nr. 1	Atributi duhet t'i jepet krijuesit.	https://creativecommons.org/licenses/by/4.0 /Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çdo formë apo format, për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial.	CC BY	
Licenca nr. 2	Atributi duhet t'i jepet krijuesit dhe përshtatjet duhet të ndahen sipas të njëjtave kushte.	https://creativecommons.org/licenses/by-sa/4.0 /Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin me çdo mjet apo format, për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial. Nëse remiksoni, adaptoni ose ndërtoni mbi materialin, duhet të licenconi materialin e modifikuar sipas termave identikë.	CC BY-SA	
Licenca nr. 3	Atributi duhet t'i jepet krijuesit dhe lejohen vetëm përdorimet jokomerciale të veprës.	https://creativecommons.org/licenses/by-nc/4.0 /Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çdo formë ose format vetëm për qëllime jokomerciale, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit.	CC BY-NC	

Licenc a nr. 4	Atributi duhet t'i jepet krijuesit. Lejohen vetëm përdorimet jokomercial e të veprës. Përshtatjet duhet të ndahen sipas të njëjtave kushte.	https://creativecommons.org/licenses/by-nc-sa/4.0/ Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çdo formë ose format vetëm për qëllime jokomerciale, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Nëse remiksoni, adaptoni ose ndërtoni mbi materialin, duhet të licenconi materialin e modifikuar sipas termave identikë.	CC BY-NC-SA	
Licenc a nr. 5	Atributi duhet t'i jepet krijuesit. Nuk lejohet asnjë derivat apo përshtatje e veprës.	https://creativecommons.org/licenses/by-nd/4.0/ Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo formë apo format vetëm në formë të paadaptuar, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit. Licenca lejon përdorimin komercial.	CC BY-ND	
Licenc a nr. 6	Atributi duhet t'i jepet krijuesit. Lejohen vetëm përdorimet jokomercial e të veprës. Nuk lejohet asnjë derivat apo përshtatje e veprës.	https://creativecommons.org/licenses/by-nc-nd/4.0/ Kjo licencë u mundëson ripërdoruesve të kopjojnë dhe shpërndajnë materialin në çdo formë apo format në formë të paadaptuar vetëm, vetëm për qëllime jokomerciale, dhe vetëm për aq kohë sa atributi i jepet krijuesit.	CC BY-NC-ND	
Licenc a nr. 7	Dedikimi i domenit publik.	Kjo licencë është një mjet dedikimi publik, i cili u mundëson krijuesve të heqin dorë nga e drejta e autorit dhe t'i fusin veprat e tyre në domenin publik mbarëbotëror. CC0 u jep mundësi ripërdoruesve të shpërndajnë, ripërziejnë, adaptojnë dhe ndërtojnë mbi materialin në çfarëdo forme apo formati, pa kushte.	CC0	

Licenca CC BY 4.0 Atribuimi 4.0 Ndërkombëtar

Shih kodin ligjor

Ju jeni të lirë të:

Ndani – kopjoni dhe rishpërndani materialin në çfarëdo mediumi apo formati për çfarëdo qëllimi, madje edhe komercial.

Përshtatni – ripërzioni, transformoni dhe ndërtoni mbi një material për çfarëdo qëllimi, madje edhe komercial.

Licencuesi nuk mund t'i revokojë këto liri për sa kohë që ju zbatoni kushtet e licencës.

Sipas kushteve të mëposhtme:

Atribuimi – Duhet të jepni *kreditin e duhur*, të jepni një link për licencën dhe të *tregoni nëse janë bërë ndryshime*. Ju mund ta bëni këtë në çfarëdo mënyre të arsyeshme, por në asnjë mënyrë e cila sugjeron që licencuesi ju miraton ju ose miraton përdorimin tuaj.

Asnjë kufizim shtesë – Nuk mund të aplikoni terma ligjorë ose *masa teknologjike* që i kufizojnë ligjërisht të tjerët të bëjnë gjithçka që lejon licenca.

Njoftimet:

Ju nuk jeni të detyruar të pajtoheni me licencën për elemente të materialit në domenin publik ose kur përdorimi juaj lejohet nga një *përrjashtim ose kufizim* i zbatueshëm.

Nuk jepen garanci. Licenca mund të mos ju japë të gjitha lejet e nevojshme për përdorimin tuaj të synuar. Për shembull, të drejta të tjera si *publiciteti, privatësia ose të drejtat morale* mund të kufizojnë mënyrën se si e përdorni materialin.

Shënimet në fund të faqes

Kredit i duhur – Nëse jepen, duhet të jepni emrin e krijuesit dhe palët e atribuimit, një njoftim për të drejtën e autorit, një njoftim licence, një njoftim për mobimin e përgjegjësive dhe një link për materialin. Licencat CC para versionit 4.0 kërkojnë gjithashtu që të jepni titullin e materialit nëse ofrohet dhe mund të ketë dallime të tjera të vogla.

tregoni nëse janë bërë ndryshime – Në 4.0, duhet të tregoni nëse keni modifikuar materialin dhe të mbani një tregues të modifikimeve të mëparshme. Në versionet 3.0 dhe versionet e mëparshme të licencës, tregimi i ndryshimeve kërkohej vetëm nëse krijoni një derivat.

masat teknologjike – Licenca ndalon zbatimin e masave efektive teknologjike, të përcaktuara duke iu referuar nenit 11 të Traktatit të së Drejtës së Autorit WIPO.

përrjashtimi ose kufizimi – Të drejtat e përdoruesve sipas përrjashtimeve dhe kufizimeve, të tilla si përdorimi i drejtë dhe trajtimi i drejtë, nuk preken nga licencat e CC.

publiciteti, privatësia ose të drejtat morale – Mund t’ju duhet të merrni leje shtesë përpara se ta përdorni materialin siç e keni qëllim.

Njoftim

Ky akt nënvizon vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet kryesore të licencës aktuale. Nuk është licencë dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Ju duhet të rishikoni me kujdes të gjitha termat dhe kushtet e licencës aktuale përpara se të përdorni materialin e licencuar.

Creative Commons nuk është një firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore. Shpërndarja, shfaqja ose lidhja me këtë akt ose licencën që ai përmbledh nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

KODI LIGJOR I CC BY 4.0

Atribuimi 4.0 Ndërkombëtar

Rreth licencës dhe Creative Commons

Korporata Creative Commons (“Creative Commons”) nuk është firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore apo këshilla ligjore. Shpërndarja e licencave publike Creative Commons nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Creative Commons i bën të disponueshme licencat e saj dhe informacionin përkatës mbi bazën “ashtu siç është”. Creative Commons nuk jep asnjë garanci në lidhje me licencat e saj, as material të licencuar sipas termave dhe kushteve të tyre, ose ndonjë informacion të lidhur. Creative Commons mohon të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i tyre në masën më të plotë të mundshme.

Përdorimi i licencave publike të Creative Commons

Licencat publike Creative Commons ofrojnë një grup standard termash dhe kushtesh që krijuesit dhe ata që gëzojnë të drejtat mund të përdorin për të ndarë veprat origjinale të autorësisë dhe materiale të tjera që i nënshtrohen së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të specifikuar në licencën publike më poshtë. Konsideratat e mëposhtme janë vetëm për qëllime informative, nuk janë shteruese dhe nuk janë pjesë e licencave tona.

Konsiderata për licencuesit

Licencat tona publike janë të destinuar për t’u përdorur nga personat e autorizuar për të dhënë leje publikut për të përdorur materiale në mënyra të cilat në raste të tjera janë të kufizuara nga e drejta e autorit dhe disa të drejta të tjera. Licencat tona janë të parevokueshme. Licencuesit duhet të lexojnë dhe kuptojnë termat dhe kushtet e licencës që ata zgjedhin përpara se ta aplikojnë atë. Licencuesit duhet gjithashtu të sigurojnë të gjitha të drejtat e nevojshme përpara se të aplikojnë licencat tona në mënyrë që publiku të mund të ripërdorë materialin siç pritej. Licencuesit duhet të shënojnë qartë çdo material që nuk i nënshtrohet licencës. Kjo përfshin materiale të tjera të licencuara nga CC, ose materiale të përdorura sipas një përrjashtimi ose kufizimi të së drejtës së autorit. [Më shumë konsiderata për licencuesit.](#)

Konsiderata për publikun

Duke përdorur një nga licencat tona publike, një licencues i jep publikut lejen për të përdorur materialin e licencuar sipas termave dhe kushteve të specifikuara. Nëse leja e licencuesit nuk është e nevojshme për ndonjë arsye – për shembull, për shkak të ndonjë përjashtimi ose kufizimi të zbatueshëm për të drejtën e autorit – atëherë ky përdorim nuk rregullohet nga licenca. Licencat tona japin vetëm leje sipas së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera që një licencues ka autoritetin t'i japë. Përdorimi i materialit të licencuar mund të jetë ende i kufizuar për arsye të tjera, duke përfshirë shkakun se persona të tjerë kanë të drejta të autorit ose të drejta të tjera në material. Një licencues mund të bëjë kërkesa të veçanta, si p.sh. të kërkojë që të gjitha ndryshimet të shënohen ose përshkruhen. Edhe pse nuk kërkohet nga licencat tona, ju inkurajojmë t'i respektoni ato kërkesa aty ku është e arsyeshme. [Më shumë konsiderata për publikun.](#)

Atribuimi 4.0 Ndërkombëtar

Duke ushtruar të drejtat e licencuara (të përcaktuara më poshtë), ju pranoni dhe bini dakord me termat dhe kushtet e kësaj licence publike ndërkombëtare, atribuimi, Creative Commons 4.0 (“Licencë publike”).

Në masën që kjo licencë publike mund të interpretohet si një kontratë, juve ju jepen të drejtat e licencuara duke marrë parasysh pranimin nga ana juaj të këtyre termave dhe kushteve dhe licencuesi ju jep këto të drejta duke marrë parasysh përfitimet që licencuesi merr nga vënia në dispozicion e materialit të licencuar sipas këtyre termave dhe kushteve.

Seksioni 1 – Përkufizime

a) Materiali i përshtatur do të thotë material që i nënshtrohet së drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme që rrjedh nga ose bazohet në materialin e licencuar dhe në të cilin materiali i licencuar është përkthyer, ndryshuar, rregulluar, transformuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë që parashikon marrjen e lejes sipas të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme që gëzon licencuesi. Për qëllimet e kësaj licence publike, ku materiali i licencuar është një vepër muzikore, performancë ose regjistrim zanor, materiali i përshtatur gjithmonë prodhohet kur materiali i licencuar sinkronizohet në marrëdhënie të kufizuar kohore me një imazh lëvizës.

b) Licenca e përshtatësit nënkupton licencën ju aplikoni për të drejtat tuaja të autorit dhe të drejtat e ngjashme në kontributet tuaja në materialin e përshtatur në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

c) E drejta e autorit dhe të drejtat e ngjashme nënkupton të drejtat e autorit dhe/ose të drejta të ngjashme të lidhura ngushtë me të drejtën e autorit, duke përfshirë, pa kufizim, performancën, transmetimin, regjistrimin e zërit dhe të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis, pa marrë parasysh se si etiketohen ose kategorizohen të drejtat. Për qëllimet e kësaj licence publike, të drejtat e specifikuara në seksionin [2\(b\)\(1\)-\(2\)](#) nuk janë të drejtat e autorit dhe të drejta të ngjashme.

d) Masat efektive teknologjike nënkuptojnë ato masa që, në mungesë të autoritetit të duhur, nuk mund të anashkalojnë sipas ligjeve që përbushin detyrimet sipas nenit 11 të Traktatit për të Drejtën e Autorit të WIPO-s miratuar më 20 dhjetor 1996 dhe/ose marrëveshjeve të ngjashme ndërkombëtare.

e) Përjashtimet dhe kufizimet nënkuptojnë përdorimin e drejtë, trajtimin e drejtë dhe/ose çdo përjashtim ose kufizim tjetër për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohet për përdorimin tuaj të materialit të licencuar.

f) Materiali i licencuar nënkupton veprën artistike ose letrare, bazën e të dhënave ose ndonjë material tjetër për të cilin licencuesi ka aplikuar për këtë licencë publike.

g) Të drejtat e licencuara nënkuptojnë të drejtat që iu janë dhënë juve, në përputhje me kushtet e kësaj licence publike, të cilat kufizohen në të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohen për përdorimin tuaj të materialit të licencuar dhe që licencuesi ka autoritetin për t'i licencuar.

h) Licencues nënkupton individin(ët) ose subjektin(et) që japin të drejta sipas kësaj licence publike.

i) Shpërndarja nënkupton ofrimin e materialit për publikun me çdo mjet ose proces që kërkon leje sipas të drejtave të licencuara, të tilla si riprodhimi, shfaqja publike, performanca publike, shpërndarja, shpërndarja, komunikimi ose importimi, dhe bërjen e materialeve të

disponueshme për publikun duke përfshirë mënyrat që anëtarët e publikut të mund të aksesojnë materialin nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre.

j) Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis nënkuptojnë të drejta të ndryshme nga e drejta e autorit që rrjedhin nga direktiva 96/9/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, të ndryshuara dhe/ose pasuese, si dhe të drejta të tjera thelbësisht ekuivalente kudo në botë.

k) Ju nënkupton individin ose subjektin që ushtron të drejtat e licencuara sipas kësaj licence publike. **Juaja** ka kuptim përkatës.

Seksioni 2 – Fushëveprimi

a) Dhënia e licencës

1) Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike, licencuesi iu jep juve një licencë mbarëbotërore, pa honorarë, jo të nënlicencueshme, joekskluzive, të përvokueshme për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e licencuar:

A. për të riprodhuar dhe shpërndarë materialin e licencuar, tërësisht ose pjesërisht; dhe

B. për të prodhuar, riprodhuar dhe ndarë materialet e përshtatura.

2. Përfshirjet dhe kufizimet. Për të shmangur çdo paqartësi, kur përfshirjet dhe kufizimet zbatohen për përdorimin tuaj, kjo licencë publike nuk zbatohet dhe ju nuk është e nevojshme të respektoni kushtet e saj.

3. Afati. Afati i kësaj licence publike është specifikuar në seksionin [6 \(a\)](#).

4. Mediat dhe formatet; modifikimet teknike të lejuara. Licencuesi ju autorizon të ushtroni të drejtat e licencuara në të gjitha mediat dhe formatet, qofshin të njohura ose të krijuara më pas, dhe të bëni modifikimet teknike të nevojshme për ta bërë këtë. Licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord të mos ushtrojë asnjë të drejtë ose autoritet për t'ju ndaluar të bëni modifikimet teknike të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencuara, duke përfshirë modifikimet teknike të nevojshme për të anashkaluar masat teknologjike efektive. Për qëllime të kësaj licence publike, thjesht duke bërë modifikime të autorizuara nga seksioni [2\(a\)\(4\)](#), nuk prodhon asnjëherë material të përshtatur.

5. Marrësit e tërthortë.

A. Ofertë nga licencuesi – Materiali i licencuar. Çdo marrës i materialit të licencuar merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara sipas termave dhe kushteve të kësaj licence publike.

B. Nuk ka kufizime për marrësit e tërthortë. Ju nuk mund të ofroni apo të impononi asnjë term apo kusht shtesë ose të ndryshëm, ose të aplikoni ndonjë masë efektive teknologjike në materialin e licencuar, nëse kjo kufizon ushtrimin e të drejtave të licencuara nga ndonjë prej përfituesve të materialit të licencuar.

6. Nuk ka asnjë miratim. Asgjë në këtë licencë publike nuk përbën, ose nuk mund të interpretohet si leje për të pretenduar ose nënkuptuar që ju, ose që përdorimi i materialit të licencuar nga ana juaj është i lidhur, ose i sponsorizuar, miratuar, ose i është dhënë status zyrtar nga licencuesi ose të tjerët që janë caktuar për të marrë atributim, siç parashikohet në seksionin [3\(a\)\(1\)\(A\)\(i\)](#).

b) Të drejta të tjera

1. Të drejtat morale, të tilla si e drejta e integritetit, nuk janë të licencuara në këtë licencë publike, as të drejtat e publicitetit, privatësisë dhe/ose të drejta të tjera të ngjashme të personalitetit; megjithatë, deri në masën e lejuar, licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord që të mos ushtrojë asnjë nga këto të drejta të mbajtura nga licencuesi deri në masën e kufizuar të nevojshme që ju lejon ju të ushtroni të drejtat e licencuara, por jo në raste të tjera.

2. Të drejtat e patentës dhe markës tregtare nuk licencohen nga kjo licencë publike.

3. Për aq sa është e lejueshme, licencuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të mbledhur honorarë nga ju për ushtrimin e të drejtave të licencuara, qoftë drejtpërdrejt ose përmes një organizate përgjegjëse për menaxhimin e honorarëve sipas ndonjë skeme licencimi vullnetare ose të licencuar, statutore ose të detyrueshme. Në të gjitha rastet e tjera, licencuesi rezervon shprehimisht çdo të drejtë për të mbledhur këta honorarë.

Seksioni 3 – Kushtet e licencës

Ushtrimi i të drejtave të licencuara i nënshtrohet shprehimisht kushteve të mëposhtme.

a) Atribuimi

1. Nëse ndani materialin e licencuar (përfshirë formën e modifikuar), duhet:

A. të ruani sa vijon nëse është marrë nga licencuesi me materialin e licencuar:

i. identifikimin e krijuesit(ve) të materialit të licencuar dhe të çdo personi tjetër të caktuar për të marrë atribut, në çdo mënyrë të arsyeshme të kërkuar nga licencuesi (duke përfshirë pseudonimin nëse është e përcaktuar);

ii. një njoftim për të drejtën e autorit;

iii. një njoftim që i referohet kësaj licence publike;

iv. një njoftim që i referohet deklaratës së mohimit të garancive;

v. një URI ose *hyperlink* me materialin e licencuar deri në masën e arsyeshme të mundshme;

B. të tregoni nëse e keni modifikuar materialin e licencuar dhe të ruani një tregues të çdo modifikimi të mëparshëm; dhe

C. të tregoni se materiali i licencuar është i licencuar sipas kësaj licence publike dhe të përfshini tekstin, ose URI-në ose *hyperlink*-un me këtë licencë publike.

2. Ju mund të përmbushni kushtet në seksionin [3\(a\)\(1\)](#) në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju shpërndani materialin e licencuar. Për shembull, mund të jetë e arsyeshme të përmbushni kushtet duke ofruar një URI ose *hyperlink* për një burim që përfshin informacionin e nevojshëm.

3. Nëse kërkohet nga licencuesi, ju duhet të hiqni çdo informacion të kërkuar nga seksioni [3\(a\)\(1\)\(A\)](#) në masën e arsyeshme të mundshme.

4. Nëse ju ndani materialin e përshtatur që prodhoni, licenca e përshtatësit që aplikoni nuk duhet të pengojë marrësit e materialit të përshtatur që të pajtohen me këtë licencë publike.

Seksioni 4 – Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis

Kur të drejtat e licencuara përfshijnë të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis që zbatohen për përdorimin nga ana juaj të materialit të licencuar:

a) për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [2\(a\)\(1\)](#) iu jep të drejtën të merrni, ripërdorni, riprodhoni dhe të ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave;

b) nëse përfshini të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave në një bazë të dhënash në të cilën ju keni të drejta të bazës së të dhënave Sui Generis, atëherë baza e të dhënave në të cilën ju keni të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis (por jo përmbajtjen e saj individuale) është material i përshtatur; dhe

c) Ju duhet të respektoni kushtet e përcaktuara në seksionin [3\(a\)](#) nëse ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [4](#) plotëson, por nuk zëvendëson detyrimet tuaja sipas kësaj licence publike ku të drejtat e licencuara përfshijnë të drejta të tjera të autorit dhe të drejta të ngjashme.

Seksioni 5 – Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë

a) Përveç rasteve kur licencuesi bie dakord ndryshe, deri në masën e lejuar, licencuesi ofron materialin e licencuar në formën që është dhe në formën e disponueshme, dhe nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci të çfarëdo lloji në lidhje me materialin e licencuar, qoftë të shprehur, të nënkuptuar, ligjor apo të ndonjë forme tjetër. Kjo përfshin, pa kufizim, garancitë e titullit, tregtueshmërisë, përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar, mosshkeljes së të drejtave të autorit, mungesës së defekteve të fshehura ose të tjera, saktësisë ose pranisë ose mungesës së gabimeve, qofshin të njohura ose të dukshme. Në rastet kur deklarata e mohimeve të garancive nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, kjo deklaratë mohimi mund të mos zbatohet për ju.

b) Për aq sa është e mundur, në asnjë rast licencuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj jush për ndonjë teori ligjore (përfshirë, pa kufizim, neglizhencë) ose ndryshe për çdo humbje, kosto të drejtpërdrejtë, të veçantë, të tërthortë, të rastësishme, të rastësishme, ndëshkuese, shembullore ose të tjera, shpenzimet ose dëmet që rrjedhin nga kjo licencë publike ose përdorimi i materialit të licencuar, edhe nëse licencuesi është informuar për mundësinë e humbjeve, kostove, shpenzimeve ose dëmeve të tilla. Kur një kufizim i përgjegjësisë nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, ky kufizim mund të mos zbatohet për ju.

c) Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjesisë të dhënë më sipër do të interpretohet në një mënyrë që, deri në masën e mundshme, të për afrojë kryesisht me një deklaratë mohimi tepër të qartë dhe heqje dorë nga të gjitha përgjegjësitë.

Seksioni 6 – Afati dhe ndërprerja

a) Kjo licencë publike zbatohet për gjithë afatin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të ngjashme të licencuara në këtë dokument. Megjithatë, nëse ju nuk arrini të pajtoheni me këtë licencë publike, atëherë të drejtat tuaja sipas kësaj licence publike ndërpriten menjëherë.

b) Kur e drejta juaj për të përdorur materialin e licencuar ka përfunduar sipas seksionit 6(a), ajo ripërcaktohet:

1. automatikisht në datën kur shkelja korrigjohet, me kusht që të korrigjohet brenda 30 ditëve pas zbulimit të shkeljes të kryer nga ana juaj; ose

2. pas ripërcaktimit të miratuar nga licencuesi.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [6 \(b\)](#) nuk prek asnjë të drejtë që licencuesi mund të ketë në kërkimin e mjeteve juridike për shkeljet e kryera nga ju të kësaj licence publike.

c) Për të shmangur çdo paqartësi, licencuesi mund ta ofrojë gjithashtu materialin e licencuar sipas termave ose kushteve të veçanta ose të ndalojë shpërndarjen e materialit të licencuar në çdo kohë; megjithatë, ky veprim nuk nënkupton ndërprerjen e kësaj licence publike.

d) Seksionet [1](#), [5](#), [6](#), [7](#) dhe [8](#) mbeten në fuqi pas ndërprerjes së kësaj licence publike.

Seksioni 7 – Terma dhe kushtet e tjera

a) Licencuesi nuk është i detyruar nga ndonjë term ose kusht tjetër shtesë ose të ndryshëm që i komunikohet nga ju, përveç rasteve kur bihet dakord shprehimisht.

b) Çdo planifikim, perceptim ose marrëveshje në lidhje me materialin e licencuar që nuk përmendet këtu është e veçantë dhe e pavarur nga termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

Seksioni 8 – Interpretimi

a) Për të shmangur çdo paqartësi, kjo licencë publike nuk interpretohet dhe nuk do të interpretohet për të reduktuar, kufizuar ose vendosur kushte për ndonjë përdorim të materialit të licencuar që mund të bëhet ligjrisht pa leje sipas kësaj licence publike.

b) Deri në masën e lejueshme, nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence publike konsiderohet e pazbatueshme, ajo do të korrigjohet menjëherë në masën minimale të nevojshme për ta bërë atë të zbatueshme. Nëse dispozita nuk mund të korrigjohet, ajo do të shkellet nga kjo licencë publike pa prekur zbatueshmërinë e termave dhe kushteve të mbetura.

c) Asnjë term ose kusht i kësaj licence publike nuk do të hiqet dhe nuk do të jepet pëlqimi për asnjë mospërputhje, përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht nga licencuesi.

d) Nuk ka asgjë në këtë licencë publike nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si kufizim ose heqje dorë nga çdo privilegj dhe imunitet që zbatohet për licencuesin ose për ju, duke përfshirë dhe ato që rrjedhin nga proceset ligjore të çdo juridiksioni ose autoriteti.

Rreth Creative Commons

Creative Commons nuk është palë në licencat e saj publike. Megjithatë, Creative Commons mund të zgjedhë të aplikojë një nga licencat e saj publike për materialin që publikon dhe në ato raste do të konsiderohet “Licencuesi”. Teksti i licencave publike të Creative Commons i kushtohet domenit publik nën [CC0 Përkushtimi i Domenit Publik](#). Me përjashtim të qëllimit të kufizuar për të treguar se materiali shpërndahet nën një licencë publike Creative Commons ose siç lejohet ndryshe nga politikat Creative Commons të publikuara në [creativecommons.org/policies](#), Creative Commons nuk autorizon përdorimin e markës tregtare “Creative Commons” ose ndonjë marke tjetër tregtare ose logoje të Creative Commons pa pëlqimin e saj paraprak me shkrim, duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me çdo modifikim të paautorizuar në ndonjë nga licencat e saj publike ose ndonjë rregullim tjetër, mirëkuptim ose marrëveshje në lidhje me përdorimin e materialit të licencuar. Për të shmangur çdo dyshim, ky paragraf nuk bën pjesë në licencat publike.

Creative Commons mund të kontaktohet në [creativecommons.org](#).

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

Ju jeni të lirë të:

Ndani – kopjoni dhe rishpërndani materialin në çfarëdo mediumi apo formati, për çfarëdo qëllimi, madje edhe komercial.

Përshtatni – ripërzieni, transformoni dhe ndërtoni mbi një material për çfarëdo qëllimi, madje edhe komercial.

Licencuesi nuk mund t'i revokojë këto liri për sa kohë që ju zbatoni kushtet e licencës.

Sipas kushteve të mëposhtme:

Atribuimi – Duhet të jepni *kreditin e duhur*, të jepni një *link* për licencën dhe të *tregoni nëse janë bërë ndryshime*. Ju mund ta bëni këtë në çfarëdo mënyre të arsyeshme, por në asnjë mënyrë e cila sugjeron që licencuesi ju miraton ju ose miraton përdorimin tuaj.

Ndani të ngjashme – Nëse ripërzieni, transformoni ose ndërtoni mbi materialin, duhet t'i shpërndani kontributet tuaja nën *të njëjtën licencë* si origjinali.

Asnjë kufizim shtesë – Nuk mund të aplikoni terma ligjorë ose *masa teknologjike* që i kufizojnë ligjërisht të tjerët të bëjnë gjithçka që lejon licenca.

Njoftimet:

Ju nuk jeni të detyruar të pajtoheni me licencën për elemente të materialit në domenin publik ose kur përdorimi juaj lejohet nga një *përyjashtim ose kufizim* i zbatueshëm.

Nuk jepen garanci. Licenca mund të mos ju japë të gjitha lejet e nevojshme për përdorimin tuaj të synuar. Për shembull, të drejta të tjera si *publiciteti, privatësia ose të drejtat morale* mund të kufizojnë mënyrën se si e përdorni materialin.

Shënimet në fund të faqes

Kredit i duhur – Nëse jepen, duhet të jepni emrin e krijuesit dhe palët e atribuimit, një njoftim për të drejtën e autorit, një njoftim licence, një njoftim për mohimin e përgjegjësisë dhe një link për materialin. Licencat CC para versionit 4.0 kërkojnë gjithashtu që të jepni titullin e materialit nëse ofrohet dhe mund të ketë dallime të tjera të vogla.

tregoni nëse janë bërë ndryshime – Në 4.0, duhet të tregoni nëse keni modifikuar materialin dhe të mbani një tregues të modifikimeve të mëparshme. Në versionet 3.0 dhe versionet e mëparshme të licencës, tregimi i ndryshimeve kërkohet vetëm nëse krijoni një derivat.

të njëjtën licencë – Ju gjithashtu mund të përdorni një licencë të listuar sit ë përputhshme në <https://creativecommons.org/compatiblelicenses>

masat teknologjike – Licenca ndalon zbatimin e masave efektive teknologjike, të përcaktuara duke in referuar nenit 11 të Traktatit të së Drejtës së Autorit WIPO.

përyjashtimi ose kufizimi – Të drejtat e përdoruesve sipas përyjashtimeve dhe kufizimeve, të tilla si përdorimi i drejtë dhe trajtimi i drejtë, nuk preken nga licencat e CC.

publiciteti, privatësia ose të drejtat morale – Mund t'ju duhet të merrni leje shtesë përpara se ta përdorni materialin siç e keni qëllim.

Njoftim

Ky akt nënvizon vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet kryesore të licencës aktuale. Nuk është licencë dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Ju duhet të rishikoni me kujdes të gjitha termat dhe kushtet e licencës aktuale përpara se të përdorni materialin e licencuar.

Creative Commons nuk është një firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore. Shpërndarja, shfaqja ose lidhja me këtë akt ose licencën që ai përmbledh nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

KODI LIGJOR I CC BY-SA 4.0

Atribuimi-Ndani të ngjashme 4.0 Ndërkombëtar

Rreth licencës dhe Creative Commons

Korporata Creative Commons (“Creative Commons”) nuk është firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore apo këshilla ligjore. Shpërndarja e licencave publike Creative Commons nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Creative Commons i bën të disponueshme licencat e saj dhe informacionin përkatës mbi bazën “ashtu siç është”. Creative

Commons nuk jep asnjë garanci në lidhje me licencat e saj, as material të licencuar sipas termave dhe kushteve të tyre, ose ndonjë informacion të lidhur. Creative Commons mohon të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i tyre në masën më të plotë të mundshme.

Përdorimi i licencave publike të Creative Commons

Licencat publike Creative Commons ofrojnë një grup standard termash dhe kushtesh që krijuesit dhe ata që gëzojnë të drejtat mund të përdorin për të ndarë veprat origjinale të autorësisë dhe materiale të tjera që i nënshtrohen së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të specifikuar në licencën publike më poshtë. Konsideratat e mëposhtme janë vetëm për qëllime informative, nuk janë shteruese dhe nuk janë pjesë e licencave tona.

Konsiderata për licencuesit

Licencat tona publike janë të destinuar për t'u përdorur nga personat e autorizuar për të dhënë leje publikut për të përdorur materiale në mënyra të cilat në raste të tjera janë të kufizuara nga e drejta e autorit dhe disa të drejta të tjera. Licencat tona janë të parevokueshme. Licencuesit duhet të lexojnë dhe kuptojnë termat dhe kushtet e licencës që ata zgjedhin përpara se ta aplikojnë atë. Licencuesit duhet gjithashtu të sigurojnë të gjitha të drejtat e nevojshme përpara se të aplikojnë licencat tona në mënyrë që publiku të mund të ripërdorë materialin siç pritej. Licencuesit duhet të shënojnë qartë çdo material që nuk i nënshtrohet licencës. Kjo përfshin materiale të tjera të licencuara nga CC, ose materiale të përdorura sipas një përjashtimi ose kufizimi të së drejtës së autorit. [Më shumë konsiderata për licencuesit.](#)

Konsiderata për publikun

Duke përdorur një nga licencat tona publike, një licencues i jep publikut lejen për të përdorur materialin e licencuar sipas termave dhe kushteve të specifikuar. Nëse leja e licencuesit nuk është e nevojshme për ndonjë arsye – për shembull, për shkak të ndonjë përjashtimi ose kufizimi të zbatueshëm për të drejtën e autorit – atëherë ky përdorim nuk rregullohet nga licenca. Licencat tona japin vetëm leje sipas së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera që një licencues ka autoritetin t'i japë. Përdorimi i materialit të licencuar mund të jetë ende i kufizuar për arsye të tjera, duke përfshirë shkakun se persona të tjerë kanë të drejta të autorit ose të drejta të tjera në material. Një licencues mund të bëjë kërkesa të veçanta, si p.sh. të kërkojë që të gjitha ndryshimet të shënohen ose përshkruhen. Edhe pse nuk kërkohet nga licencat tona, ju inkurajojmë t'i respektoni ato kërkesa aty ku është e arsyeshme. [Më shumë konsiderata për publikun.](#)

Atribuimi-Ndani të ngjashme 4.0 Ndërkombëtar

Duke ushtruar të drejtat e licencuara (të përcaktuara më poshtë), ju pranoni dhe bini dakord të zbatoni termat dhe kushtet e kësaj licence publike ndërkombëtare atribuimi-ndani të ngjashme 4.0 të Creative Commons (“Licencë publike”).

Në masën që kjo licencë publike mund të interpretohet si një kontratë, juve ju jepen të drejtat e licencuara duke marrë parasysh pranimin nga ana juaj të këtyre termave dhe kushteve dhe licencuesi ju jep këto të drejta duke marrë parasysh përfitimet që licencuesi merr nga vënia në dispozicion e materialit të licencuar sipas këtyre termave dhe kushteve.

Seksioni 1 – Përkufizime

a) Materiali i përshtatur do të thotë material që i nënshtrohet së drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme që rrjedh nga ose bazohet në materialin e licencuar dhe në të cilin materiali i licencuar është përkthyer, ndryshuar, rregulluar, transformuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë që parashikon marrjen e lejes sipas të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme që gëzon licencuesi. Për qëllimet e kësaj licence publike, ku materiali i licencuar është një vepër muzikore, performancë ose regjistrim zanor, materiali i përshtatur gjithmonë prodhohet kur materiali i licencuar sinkronizohet në marrëdhënie të kufizuar kohore me një imazh lëvizës.

b) Licenca e përshtatësit nënkupton licencën ju aplikoni për të drejtat tuaja të autorit dhe të drejtat e ngjashme në kontributet tuaja në materialin e përshtatur në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

c) Licenca e përputhshme BY-SA do të thotë një licencë e listuar në: creativecommons.org/compatiblelicenses, i miratuar nga Creative Commons, e cila në thelb është ekuivalente e kësaj licence publike.

d) E drejta e autorit dhe të drejtat e ngjashme nënkupton të drejtat e autorit dhe/ose të drejta të ngjashme të lidhura ngushtë me të drejtën e autorit, duke përfshirë, pa kufizim,

performancën, transmetimin, regjistrimin e zërit dhe të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis, pa marrë parasysh se si etiketohen ose kategorizohen të drejtat. Për qëllimet e kësaj licence publike, të drejtat e specifikuar në seksionin [2\(b\)\(1\)-\(2\)](#) nuk janë të drejtat e autorit dhe të drejta të ngjashme.

e) Masat efektive teknologjike nënkuptojnë ato masa që, në mungesë të autoritetit të duhur, nuk mund të anashkalohen sipas ligjeve që përmbushin detyrimet sipas nenit 11 të Traktatit për të Drejtën e Autorit të WIPO-s miratuar më 20 dhjetor 1996 dhe/ose marrëveshjeve të ngjashme ndërkombëtare.

f) Përrjashtimet dhe kufizimet nënkuptojnë përdorimin e drejtë, trajtimin e drejtë dhe/ose çdo përrjashtim ose kufizim tjetër për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohet për përdorimin tuaj të materialit të licencuar.

g) Elementet e licencës nënkupton atributet e licencës të listuara në emrin e një licence publike Creative Commons. Elementet e licencës të kësaj licence publike janë atribuimi dhe ndani të ngjashme.

h) Materiali i licencuar nënkupton veprën artistike ose letrare, bazën e të dhënave ose ndonjë material tjetër për të cilin licencuesi ka aplikuar për këtë licencë publike.

i) Të drejtat e licencuara nënkuptojnë të drejtat që iu janë dhënë juve, në përputhje me kushtet e kësaj licence publike, të cilat kufizohen në të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohen për përdorimin tuaj të materialit të licencuar dhe që licencuesi ka autoritetin për t'i licencuar.

j) Licencues nënkupton individin(ët) ose subjektin(et) që japin të drejta sipas kësaj licence publike.

k) Shpërndarja nënkupton ofrimin e materialit për publikun me çdo mjet ose proces që kërkon leje sipas të drejtave të licencuara, të tilla si riprodhimi, shfaqja publike, performanca publike, shpërndarja, shpërndarja, komunikimi ose importimi, dhe bërjen e materialeve të disponueshme për publikun duke përfshirë mënyrat që anëtarët e publikut të mund të aksesojnë materialin nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre.

l) Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis nënkuptojnë të drejta të ndryshme nga e drejta e autorit që rrjedhin nga direktiva 96/9/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, të ndryshuara dhe/ose pasuese, si dhe të drejta të tjera thelbësisht ekuivalente kudo në botë.

m) Ju nënkupton individin ose subjektin që ushtron të drejtat e licencuara sipas kësaj licence publike. **Juaja** ka kuptim përkatës.

Seksioni 2 – Fushëveprimi

a) Dhënia e licencës

1. Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike, licencuesi iu jep juve një licencë mbarëbotërore, pa honorarë, jo të nënlicencueshme, joekskluzive, të parevokueshme për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e licencuar:

A. për të riprodhuar dhe shpërndarë materialin e licencuar, tërësisht ose pjesërisht; dhe

B. për të prodhuar, riprodhuar dhe ndarë materialet e përshtatura.

2. **Përrjashtimet dhe kufizimet.** Për të shmangur çdo paqartësi, kur përrjashtimet dhe Kufizimet zbatohen për përdorimin tuaj, kjo licencë publike nuk zbatohet dhe ju nuk është e nevojshme të respektoni kushtet e saj.

3. **Afati.** Afati i kësaj licence publike është specifikuar në seksionin [6 \(a\)](#).

4. **Mediat dhe formatet; modifikimet teknike të lejuara.** Licencuesi ju autorizon të ushtroni të drejtat e licencuara në të gjitha mediat dhe formatet, qofshin të njohura ose të krijuara më pas, dhe të bëni modifikimet teknike të nevojshme për ta bërë këtë. Licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord të mos ushtrojë asnjë të drejtë ose autoritet për t'ju ndaluar të bëni modifikimet teknike të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencuara, duke përfshirë modifikimet teknike të nevojshme për të anashkaluar masat teknologjike efektive. Për qëllime të kësaj licence publike, thjesht duke bërë modifikime të autorizuar nga seksioni [2\(a\)\(4\)](#), nuk prodhon asnjëherë material të përshtatur.

5. Marrësit e tërthortë.

A. Ofertë nga licencuesi – Materiali i licencuar. Çdo marrës i materialit të licencuar merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara sipas termave dhe kushteve të kësaj licence publike.

B. Ofertë shtesë nga licencuesi – Materiali i përshtatur. Çdo marrës i materialit të përshtatur nga ju merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e përshtatur sipas kushteve të licencës së përshtatësit që ju aplikoni.

C. Nuk ka kufizime për marrësit e tërthortë. Ju nuk mund të ofroni apo të impononi asnjë term apo kusht shtesë ose të ndryshëm, ose të aplikoni ndonjë masë efektive teknologjike në materialin e licencuar, nëse kjo kufizon ushtrimin e të drejtave të licencuara nga ndonjë prej përfituesve të materialit të licencuar.

6. Nuk ka asnjë miratim. Asgjë në këtë licencë publike nuk përbën, ose nuk mund të interpretohet si leje për të pretenduar ose nënkuptuar që ju, ose që përdorimi i materialit të licencuar nga ana juaj është i lidhur, ose i sponsorizuar, miratuar, ose i është dhënë status zyrtar nga licencuesi ose të tjerët që janë caktuar për të marrë atribum, siç parashikohet në seksionin [3\(a\)\(1\)\(A\)\(i\)](#).

b) Të drejta të tjera

1. Të drejtat morale, të tilla si e drejta e integritetit, nuk janë të licencuara në këtë licencë publike, as të drejtat e publicitetit, privatësisë dhe/ose të drejta të tjera të ngjashme të personalitetit; megjithatë, deri në masën e lejuar, licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord që të mos ushtrojë asnjë nga këto të drejta të mbajtura nga licencuesi deri në masën e kufizuar të nevojshme që ju lejon Ju të ushtroni të drejtat e licencuara, por jo në raste të tjera.

2. Të drejtat e patentës dhe markës tregtare nuk licencohen nga kjo licencë publike.

3. Për aq sa është e lejueshme, licencuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të mbledhur honorarë nga ju për ushtrimin e të drejtave të licencuara, qoftë drejtpërdrejt ose përmes një organizate përgjegjëse për menaxhimin e honorarëve sipas ndonjë skeme licencimi vullnetare ose të licencuar, statutore ose të detyrueshme. Në të gjitha rastet e tjera, licencuesi rezervon shprehimisht çdo të drejtë për të mbledhur këta honorarë.

Seksioni 3 – Kushtet e licencës

Ushtrimi i të drejtave të licencuara i nënshtrohet shprehimisht kushteve të mëposhtme.

a) Atribumi.

1. Nëse ndani materialin e licencuar (përfshirë formën e modifikuar), duhet:

A. të ruani sa vijon nëse është marrë nga licencuesi me materialin e licencuar:

i. identifikimin e krijuesit(ve) të materialit të licencuar dhe të çdo personi tjetër të caktuar për të marrë atribut, në çdo mënyrë të arsyeshme të kërkuar nga licencuesi (duke përfshirë pseudonimin nëse është e përcaktuar);

ii. një njoftim për të drejtën e autorit;

iii. një njoftim që i referohet kësaj licence publike;

iv. një njoftim që i referohet deklaratës së mohimit të garancive;

v. një URI ose *hyperlink* me materialin e licencuar deri në masën e arsyeshme të mundshme;

B. të tregoni nëse e keni modifikuar materialin e licencuar dhe të ruani një tregues të çdo modifikimi të mëparshëm; dhe

C. të tregoni se materiali i licencuar është i licencuar sipas kësaj licence publike dhe të përfshini tekstin, ose URI-në ose *hyperlink*-un me këtë licencë publike.

2. Ju mund të përmbushni kushtet në seksionin [3\(a\)\(1\)](#) në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju shpërndani materialin e licencuar. Për shembull, mund të jetë e arsyeshme të përmbushni kushtet duke ofruar një URI ose *hyperlink* për një burim që përfshin informacionin e nevojshëm.

3. Nëse kërkohet nga licencuesi, ju duhet të hiqni çdo informacion të kërkuar nga seksioni [3\(a\)\(1\)\(A\)](#) në masën e arsyeshme të mundshme.

b) Ndani të ngjashme

Përveç kushteve në seksionin 3 (a), nëse ndani materialin e përshtatur që prodhoni, zbatohen gjithashtu kushtet e mëposhtme.

1. Licenca e përshtatësit që aplikoni duhet të jetë një licencë Creative Commons me të njëjtat elemente licence, në këtë version ose më të ri, ose një licencë e përputhshme BY-SA.

2. Ju duhet të përfshini tekstin, ose URI-në, ose hiperlink-un me licencën e përshtatësit që aplikoni. Ju mund ta plotësoni këtë kusht në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju ndani materialin e përshtatur.

3. Ju nuk mund të ofroni ose impononi terma ose kushte shtesë ose të ndryshme, as të aplikoni ndonjë masë teknologjike efektive për materialin e përshtatur që kufizon ushtrimin e të drejtave të dhëna sipas licencës së përshtatësit që ju aplikoni.

Seksioni 4 – Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis

Kur të drejtat e licencuara përfshijnë të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis që zbatohen për përdorimin nga ana juaj të materialit të licencuar:

a) për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [2\(a\)\(1\)](#) iu jep të drejtën të merrni, ripërdorni, riprodhoni dhe të ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave;

b) nëse përfshini të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave në një bazë të dhënash në të cilën ju keni të drejta të bazës së të dhënave Sui Generis, atëherë baza e të dhënave në të cilën ju keni të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis (por jo përmbajtjen e saj individuale) është material i përshtatur, duke përfshirë për qëllime të seksionit 3(b); dhe

c) Ju duhet të respektoni kushtet e përcaktuara në seksionin [3\(a\)](#) nëse ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [4](#) plotëson, por nuk zëvendëson detyrimet tuaja sipas kësaj licence publike ku të drejtat e licencuara përfshijnë të drejta të tjera të autorit dhe të drejta të ngjashme.

Seksioni 5 – Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë.

a) Përveç rasteve kur licencuesi bie dakord ndryshe, deri në masën e lejuar, Licencuesi ofron materialin e licencuar në formën që është dhe në formën e disponueshme, dhe nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci të çfarëdo lloji në lidhje me materialin e licencuar, qoftë të shprehur, të nënkuptuar, ligjor apo të ndonjë forme tjetër. Kjo përfshin, pa kufizim, garancitë e titullit, tregtueshmërisë, përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar, mosshkeljes së të drejtave të autorit, mungesës së defekteve të fshehura ose të tjera, saktësisë ose pranisë ose mungesës së gabimeve, qofshin të njohura ose të dukshme. Në rastet kur deklarata e mohimeve të garancive nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, kjo deklaratë mohimi mund të mos zbatohet për ju.

b) Për aq sa është e mundur, në asnjë rast licencuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj jush për ndonjë teori ligjore (përfshirë, pa kufizim, neglizhencë) ose ndryshe për çdo humbje, kosto të drejtpërdrejtë, të veçantë, të tërthortë, të rastësishme, të rastësishme, ndëshkuese, shembullore ose të tjera, shpenzimet ose dëmet që rrjedhin nga kjo licencë publike ose përdorimi i materialit të licencuar, edhe nëse licencuesi është informuar për mundësinë e humbjeve, kostove, shpenzimeve ose dëmeve të tilla. Kur një kufizim i përgjegjësisë nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, ky kufizim mund të mos zbatohet për ju.

c) Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë të dhënë më sipër do të interpretohet në një mënyrë që, deri në masën e mundshme, të për afrojë kryesisht me një deklaratë mohimi tepër të qartë dhe heqje dorë nga të gjitha përgjegjësitë.

Seksioni 6 – Afati dhe ndërprerja

a) Kjo licencë publike zbatohet për gjithë afatin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të ngjashme të licencuara në këtë dokument. Megjithatë, nëse ju nuk arrini të pajtoheni me këtë licencë publike, atëherë të drejtat tuaja sipas kësaj licence publike ndërpriten menjëherë.

b) Kur e drejta juaj për të përdorur materialin e licencuar ka përfunduar sipas seksionit 6(a), ajo ripërcaktohet:

1. automatikisht në datën kur shkelja korrigjohet, me kusht që të korrigjohet brenda 30 ditëve pas zbulimit të shkeljes të kryer nga ana juaj; ose

2. pas ripërcaktimit të miratuar nga licencuesi.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [6\(b\)](#) nuk prek asnjë të drejtë që licencuesi mund të ketë në kërkimin e mjeteve juridike për shkeljet e kryera nga ju të kësaj licence publike.

c) Për të shmangur çdo paqartësi, licencuesi mund ta ofrojë gjithashtu materialin e licencuar sipas termave ose kushteve të veçanta ose të ndalojë shpërndarjen e materialit të licencuar në çdo kohë; megjithatë, ky veprim nuk nënkupton ndërprerjen e kësaj licence publike.

d) Seksionet [1](#), [5](#), [6](#), [7](#) dhe [8](#) mbeten në fuqi pas ndërprerjes së kësaj licence publike.

Seksioni 7 – Terma dhe kushtet e tjera

a) Licencuesi nuk është i detyruar nga ndonjë term ose kusht tjetër shtesë ose të ndryshëm që i komunikohet nga ju, përveç rasteve kur bihet dakord shprehimisht.

b) Çdo planifikim, perceptim ose marrëveshje në lidhje me materialin e licencuar që nuk përmendet këtu është e veçantë dhe e pavarur nga termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

Seksioni 8 – Interpretimi

a) Për të shmangur çdo paqartësi, kjo licencë publike nuk interpretohet dhe nuk do të interpretohet për të reduktuar, kufizuar ose vendosur kushte për ndonjë përdorim të Materialit të Licencuar që mund të bëhet ligjrisht pa leje sipas kësaj licence publike.

b) Deri në masën e lejueshme, nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence publike konsiderohet e pazbatueshme, ajo do të korrigohet menjëherë në masën minimale të nevojshme për ta bërë atë të zbatueshme. Nëse dispozita nuk mund të korrigohet, ajo do të shkëputet nga kjo licencë publike pa prekur zbatueshmërinë e termave dhe kushteve të mbetura.

c) Asnjë term ose kusht i kësaj licence publike nuk do të hiqet dhe nuk do të jepet pëlqimi për asnjë mospërputhje, përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht nga licencuesi.

d) Nuk ka asgjë në këtë licencë publike nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si kufizim ose heqje dorë nga çdo privilegj dhe imunitet që zbatohet për licencuesin ose për ju, duke përfshirë dhe ato që rrjedhin nga proceset ligjore të çdo juridiksioni ose autoriteti.

Rreth Creative Commons

Creative Commons nuk është palë në licencat e saj publike. Megjithatë, Creative Commons mund të zgjedhë të aplikojë një nga licencat e saj publike për materialin që publikon dhe në ato raste do të konsiderohet “Licencuesi”. Teksti i licencave publike të Creative Commons i kushtohet domenit publik nën [CC0 Përkushtimi i Domenit Publik](#). Me përjashtim të qëllimit të kufizuar për të treguar se materiali shpërndahet nën një licencë publike Creative Commons ose siç lejohet ndryshe nga politikat Creative Commons të publikuara në creativecommons.org/policies, Creative Commons nuk autorizon përdorimin e markës tregtare “Creative Commons” ose ndonjë marke tjetër tregtare ose logoje të Creative Commons pa pëlqimin e saj paraprak me shkrim, duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me çdo modifikim të paautorizuar në ndonjë nga licencat e saj publike ose ndonjë rregullim tjetër, mirëkuptim ose marrëveshje në lidhje me përdorimin e materialit të licencuar. Për të shmangur çdo dyshim, ky paragraf nuk bën pjesë në licencat publike.

Creative Commons mund të kontaktohet në creativecommons.org.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

Licenca CC BY-NC 4.0 Atribuimi-Jokomercial 4.0 Ndërkombëtar

Shih kodin ligjor

Ju jeni të lirë të:

Ndani – kopjoni dhe rishpërndani materialin në çfarëdo mediumi apo formati.

Përshtatni- ripërziëni, transformoni dhe ndërtoni mbi një material.

Licencuesi nuk mund t’i revokojë këto liri për sa kohë që ju zbatoni kushtet e licencës.

Sipas kushteve të mëposhtme:

Atribuimi – Duhet të jepni *kreditin e duhur*, të jepni një link për licencën dhe të *tregoni nëse janë bërë ndryshime*. Ju mund ta bëni këtë në çfarëdo mënyre të arsyeshme, por në asnjë mënyrë e cila sugjeron që licencuesi ju miraton ju ose miraton përdorimin tuaj.

Jokomerciale – Ju nuk mund ta përdorni materialin për *qëllime komerciale*.

Asnjë kufizim shtesë – Nuk mund të aplikoni terma ligjorë ose *masa teknologjike* që i kufizojnë ligjrisht të tjerët të bëjnë gjithçka që lejon licenca.

Njoftimet:

Ju nuk jeni të detyruar të pajtoheni me licencën për elemente të materialit në domenin publik ose kur përdorimi juaj lejohet nga një *përrjashtim ose kufizim* i zbatueshëm.

Nuk jepen garanci. Licenca mund të mos ju japë të gjitha lejet e nevojshme për përdorimin tuaj të synuar. Për shembull, të drejta të tjera si *publiciteti, privatësia ose të drejtat morale* mund të kufizojnë mënyrën se si e përdorni materialin.

Shënimet në fund të faqes

Kredit i duhur – Nëse jepen, duhet të jepni emrin e krijuesit dhe palët e atribuimit, një njoftim për të drejtën e autorit, një njoftim licence, një njoftim për mobimin e përgjegjesisë dhe një link për materialin. Licencat CC para versionit 4.0 kërkojnë gjithashtu që të jepni titullin e materialit nëse ofrohet dhe mund të ketë dallime të tjera të vogla.

tregoni nëse janë bërë ndryshime – Në 4.0, duhet të tregoni nëse keni modifikuar materialin dhe të mbani një tregues të modifikimeve të mëparshme. Në versionet 3.0 dhe versionet e mëparshme të licencës, tregimi i ndryshimeve kërkohet vetëm nëse krijoni një derivat.

qëllime komerciale – Një përdorim komercial është ai që synohet kryesisht për përfitim komercial ose kompensim monetar

masat teknologjike – Licenca ndalon zbatimin e masave efektive teknologjike, të përcaktuara duke iu referuar nenit 11 të Traktatit të së Drejtës së Autorit WIPO.

përrjashtimi ose kufizimi – Të drejtat e përdoruesve sipas përrjashtimeve dhe kufizimeve, të tilla si përdorimi i drejtë dhe trajtimi i drejtë, nuk preken nga licencat e CC.

publiciteti, privatësia ose të drejtat morale – Mund t'ju duhet të merrni leje shtesë përpara se ta përdorni materialin siç e keni qëllim.

Njoftim

Ky akt nënvizon vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet kryesore të licencës aktuale. Nuk është licencë dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Ju duhet të rishikoni me kujdes të gjitha termat dhe kushtet e licencës aktuale përpara se të përdorni materialin e licencuar.

Creative Commons nuk është një firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore. Shpërndarja, shfaqja ose lidhja me këtë akt ose licencën që ai përmbledh nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

KODI LIGJOR i CC BY - NC 4.0

Atribuimi-Jokomercial 4.0 Ndërkombëtar

Rreth licencës dhe Creative Commons

Korporata Creative Commons (“Creative Commons”) nuk është firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore apo këshilla ligjore. Shpërndarja e licencave publike Creative Commons nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Creative Commons i bën të disponueshme licencat e saj dhe informacionin përkatës mbi bazën “ashtu siç është”. Creative Commons nuk jep asnjë garanci në lidhje me licencat e saj, as material të licencuar sipas termave dhe kushteve të tyre, ose ndonjë informacion të lidhur. Creative Commons mohon të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i tyre në masën më të plotë të mundshme.

Përdorimi i licencave publike të Creative Commons

Licencat publike Creative Commons ofrojnë një grup standard termash dhe kushtesh që krijuesit dhe ata që gëzojnë të drejtat mund të përdorin për të ndarë veprat origjinale të autorësisë dhe materiale të tjera që i nënshtrohen së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të specifikuar në licencën publike më poshtë. Konsideratat e mëposhtme janë vetëm për qëllime informative, nuk janë shteruese dhe nuk janë pjesë e licencave tona.

Konsiderata për licencuesit

Licencat tona publike janë të destinuar për t'u përdorur nga personat e autorizuar për të dhënë leje publikut për të përdorur materiale në mënyra të cilat në raste të tjera janë të kufizuara nga e drejta e autorit dhe disa të drejta të tjera. Licencat tona janë të parevokueshme. Licencuesit duhet të lexojnë dhe kuptojnë termat dhe kushtet e licencës që ata zgjedhin përpara se ta aplikojnë atë. Licencuesit duhet gjithashtu të sigurojnë të gjitha të drejtat e nevojshme përpara se të aplikojnë licencat tona në mënyrë që publiku të mund të ripërdorë materialin siç pritej.

Licencuesit duhet të shënojnë qartë çdo material që nuk i nënshtrohet licencës. Kjo përfshin materiale të tjera të licencuara nga CC, ose materiale të përdorura sipas një përjashtimi ose kufizimi të së drejtës së autorit. [Më shumë konsiderata për licencuesit.](#)

Konsiderata për publikun

Duke përdorur një nga licencat tona publike, një licencues i jep publikut lejen për të përdorur materialin e licencuar sipas termave dhe kushteve të specifikuara. Nëse leja e licencuesit nuk është e nevojshme për ndonjë arsye – për shembull, për shkak të ndonjë përjashtimi ose kufizimi të zbatueshëm për të drejtën e autorit – atëherë ky përdorim nuk rregullohet nga licenca. Licencat tona japin vetëm leje sipas së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera që një licencues ka autoritetin t'i japë. Përdorimi i materialit të licencuar mund të jetë ende i kufizuar për arsye të tjera, duke përfshirë shkakun se persona të tjerë kanë të drejta të autorit ose të drejta të tjera në material. Një licencues mund të bëjë kërkesa të veçanta, si p.sh. të kërkojë që të gjitha ndryshimet të shënohen ose përshkruhen. Edhe pse nuk kërkohet nga licencat tona, ju inkurajojmë t'i respektoni ato kërkesa aty ku është e arsyeshme. [Më shumë konsiderata për publikun.](#)

Atribuimi - Jokomercial 4.0 Ndërkombëtar

Duke ushtruar të drejtat e licencuara (të përcaktuara më poshtë), ju pranoni dhe bini dakord të jeni të detyruar nga termat dhe kushtet e kësaj licence publike ndërkombëtare, atribuimi, jokomerciale Creative Commons 4.0 (“Licencë publike”).

Në masën që kjo licencë publike mund të interpretohet si një kontratë, juve ju jepen të drejtat e licencuara duke marrë parasysh pranimin nga ana juaj të këtyre termave dhe kushteve dhe licencuesi ju jep këto të drejta duke marrë parasysh përfitimet që licencuesi merr nga vënia në dispozicion e materialit të licencuar sipas këtyre termave dhe kushteve.

Seksioni 1 – Përkufizime

a) Materiali i përshtatur do të thotë material që i nënshtrohet së drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme që rrjedh nga ose bazohet në materialin e licencuar dhe në të cilin materiali i licencuar është përkthyer, ndryshuar, rregulluar, transformuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë që parashikon marrjen e lejes sipas të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme që gëzon licencuesi. Për qëllimet e kësaj licence publike, ku materiali i licencuar është një veper muzikore, performancë ose regjistrim zanor, materiali i përshtatur gjithmonë prodhohet kur materiali i licencuar sinkronizohet në marrëdhënie të kufizuar kohore me një imazh lëvizës.

b) Licenca e përshtatësit nënkupton licencën ju aplikoni për të drejtat tuaja të autorit dhe të drejtat e ngjashme në kontributet tuaja në materialin e përshtatur në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

c) E drejta e autorit dhe të drejtat e ngjashme nënkupton të drejtat e autorit dhe/ose të drejta të ngjashme të lidhura ngushtë me të drejtën e autorit, duke përfshirë, pa kufizim, performancën, transmetimin, regjistrimin e zërit dhe të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis, pa marrë parasysh se si etiketohen ose kategorizohen të drejtat. Për qëllimet e kësaj licence publike, të drejtat e specifikuara në seksionin [2\(b\)\(1\)-\(2\)](#) nuk janë të drejtat e autorit dhe të drejta të ngjashme.

d) Masat efektive teknologjike nënkuptojnë ato masa që, në mungesë të autoritetit të duhur, nuk mund të anashkalohen sipas ligjeve që përmbushin detyrimet sipas nenit 11 të Traktatit për të Drejtën e Autorit të WIPO-s miratuar më 20 dhjetor 1996 dhe/ose marrëveshjeve të ngjashme ndërkombëtare.

e) Përjashtimet dhe kufizimet nënkuptojnë përdorimin e drejtë, trajtimin e drejtë dhe/ose çdo përjashtim ose kufizim tjetër për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohet për përdorimin tuaj të materialit të licencuar.

f) Materiali i licencuar nënkupton veprën artistike ose letrare, bazën e të dhënave ose ndonjë material tjetër për të cilin licencuesi ka aplikuar për këtë licencë publike.

g) Të drejtat e licencuara nënkuptojnë të drejtat që iu janë dhënë juve, në përputhje me kushtet e kësaj licence publike, të cilat kufizohen në të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohen për përdorimin tuaj të materialit të licencuar dhe që licencuesi ka autoritetin për t'i licencuar.

h) Licencues nënkupton individin(ët) ose subjektin(et) që japin të drejta sipas kësaj licence publike.

i) Jokomerciale nënkupton që kryesisht nuk synohet ose nuk drejtohet drejt përfitimit komercial ose kompensimit monetar. Për qëllime të kësaj licence publike, shkëmbimi i materialit të licencuar për materiale të tjera që i nënshtrohen të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme me anë të ndarjes së dosjeve digjitale ose me anë të mjeteve të ngjashme është jokomercial me kusht që të mos ketë pagesë për kompensimin monetar në lidhje me këtë shkëmbim.

j) Shpërndarja nënkupton ofrimin e materialit për publikun me çdo mjet ose proces që kërkon leje sipas të drejtave të licencuara, të tilla si riprodhimi, shfaqja publike, performanca publike, shpërndarja, shpërndarja, komunikimi ose importimi, dhe bërjen e materialeve të disponueshme për publikun duke përfshirë mënyrat që anëtarët e publikut të mund të aksesojnë materialin nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre.

k) Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis nënkuptojnë të drejta të ndryshme nga e drejta e autorit që rrjedhin nga direktiva 96/9/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, të ndryshuara dhe/ose pasuese, si dhe të drejta të tjera thelbësisht ekuivalente kudo në botë.

l) Ju nënkupton individin ose subjektin që ushtron të drejtat e licencuara sipas kësaj licence publike. **Juaja** ka kuptim përkatës.

Seksioni 2 – Fushëveprimi

a) Dhënia e licencës

1. Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike, licencuesi iu jep juve një licencë mbarëbotërore, pa honorarë, jo të nënlicencueshme, joekskluzive, të parevokueshme për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e licencuar:

A. Riprodhimi dhe shpërndarja e materialit të licencuar, tërësisht ose pjesërisht; vetëm për qëllime jokomerciale; dhe

B. Prodhimi, riprodhimi dhe shpërndarja e materialit të përshtatur vetëm për qëllime jokomerciale.

2. Përfshirjet dhe kufizimet. Për të shmangur çdo paqartësi, kur përfshirjet dhe kufizimet zbatohen për përdorimin tuaj, kjo licencë publike nuk zbatohet dhe ju nuk është e nevojshme të respektoni kushtet e saj.

3. Afati. Afati i kësaj licence publike është specifikuar në seksionin [6 \(a\)](#).

4. Mediat dhe formatet; modifikimet teknike të lejuara. Licencuesi ju autorizon të ushtroni të drejtat e licencuara në të gjitha mediat dhe formatet, qofshin të njohura ose të krijuara më pas, dhe të bëni modifikimet teknike të nevojshme për ta bërë këtë. Licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord të mos ushtrojë asnjë të drejtë ose autoritet për t'ju ndaluar të bëni modifikimet teknike të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencuara, duke përfshirë modifikimet teknike të nevojshme për të anashkaluar masat teknologjike efektive. Për qëllime të kësaj licence publike, thjesht duke bërë modifikime të autorizuar nga seksioni [2\(a\)\(4\)](#), nuk prodhon asnjëherë material të përshtatur.

5. Marrësit që marrin të dhëna drejtpërdrejt ose tërthorazi.

A. Ofertë nga licencuesi – materiali i licencuar. Çdo marrës i materialit të licencuar merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara sipas termave dhe kushteve të kësaj licence publike.

B. Nuk ka kufizime për marrësit e tërthortë. Ju nuk mund të ofroni apo të impononi asnjë term apo kusht shtesë ose të ndryshëm, ose të aplikoni ndonjë masë efektive teknologjike në materialin e licencuar, nëse kjo kufizon ushtrimin e të drejtave të licencuara nga ndonjë prej përfituesve të materialit të licencuar.

6. Nuk ka asnjë miratim. Asgjë në këtë licencë publike nuk përbën, ose nuk mund të interpretohet si leje për të pretenduar ose nënkuptuar që ju, ose që përdorimi i materialit të licencuar nga ana juaj është i lidhur, ose i sponsorizuar, miratuar, ose i është dhënë status zyrtar nga licencuesi ose të tjerët që janë caktuar për të marrë atributim, siç parashikohet në seksionin [3\(a\)\(1\)\(A\)\(i\)](#).

b) Të drejta të tjera

1. Të drejtat morale, të tilla si e drejta e integritetit, nuk janë të licencuara në këtë licencë publike, as të drejtat e publicitetit, privatësisë dhe/ose të drejta të tjera të ngjashme të personalitetit; megjithatë, deri në masën e lejuar, licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord që të

mos ushtrojë asnjë nga këto të drejta të mbajtura nga licencuesi deri në masën e kufizuar të nevojshme që ju lejon ju të ushtroni të drejtat e licencuara, por jo në raste të tjera.

2. Të drejtat e patentës dhe markës tregtare nuk licencohen nga kjo licencë publike.

3. Për aq sa është e lejueshme, licencuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të mbledhur honorarë nga ju për ushtrimin e të drejtave të licencuara, qoftë drejtpërdrejt ose përmes një organizate përgjegjëse për menaxhimin e honorarëve sipas ndonjë skeme licencimi vullnetare ose të licencuar, statutore ose të detyrueshme. Në të gjitha rastet e tjera, licencuesi rezervon shprehimisht çdo të drejtë për t'i mbledhur këta honorarë, duke përfshirë rastin kur materiali i licencuar përdoret ndryshe nga qëllimet jokomerciale.

Seksioni 3 – Kushtet e licencës

Ushtrimi i të drejtave të licencuara i nënshtrohet shprehimisht kushteve të mëposhtme.

a) Atribuimi

1. Nëse ndani materialin e licencuar (përfshirë formën e modifikuar), duhet:

A. të ruani sa vijon nëse është marrë nga licencuesi me materialin e licencuar:

i. identifikimin e krijuesit(ve) të materialit të licencuar dhe të çdo personi tjetër të caktuar për të marrë atribut, në çdo mënyrë të arsyeshme të kërkuar nga licencuesi (duke përfshirë pseudonimin nëse është e përcaktuar);

ii. një njoftim për të drejtën e autorit;

iii. një njoftim që i referohet kësaj licence publike;

iv. një njoftim që i referohet deklaratës së mohimit të garancive;

v. një URI ose *hyperlink* me materialin e licencuar deri në masën e arsyeshme të mundshme;

B. të tregoni nëse e keni modifikuar materialin e licencuar dhe të ruani një tregues të çdo modifikimi të mëparshëm; dhe

C. të tregoni se materiali i licencuar është i licencuar sipas kësaj licence publike dhe të përfshini tekstin, ose URI-në ose *hyperlink*-un me këtë licencë publike.

2. Ju mund të përmbushni kushtet në seksionin [3\(a\)\(1\)](#) në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju shpërndani materialin e licencuar. Për shembull, mund të jetë e arsyeshme të përmbushni kushtet duke ofruar një URI ose *hyperlink* për një burim që përfshin informacionin e nevojshëm.

3. Nëse kërkohet nga licencuesi, ju duhet të hiqni çdo informacion të kërkuar nga seksioni [3\(a\)\(1\)\(A\)](#) në masën e arsyeshme të mundshme.

4. Nëse ju ndani materialin e përshtatur që prodhoni, licenca e përshtatësit që aplikoni nuk duhet të pengojë marrësit e materialit të përshtatur që të pajtohen me këtë licencë publike.

Seksioni 4 – Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis

Kur të drejtat e licencuara përfshijnë të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis që zbatohen për përdorimin nga ana juaj të materialit të licencuar:

a) për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [2\(a\)\(1\)](#) iu jep të drejtën për të nxjerrë, ripërdorur, riprodhuar dhe ndarë të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave vetëm për qëllime jokomerciale;

b) nëse përfshini të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave në një bazë të dhënash në të cilën ju keni të drejta të bazës së të dhënave Sui Generis, atëherë baza e të dhënave në të cilën ju keni të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis (por jo përmbajtjen e saj individuale) është material i përshtatur; dhe

c) Ju duhet të respektoni kushtet e përcaktuara në seksionin [3\(a\)](#) nëse ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [4](#) plotëson, por nuk zëvendëson detyrimet tuaja sipas kësaj licence publike ku të drejtat e licencuara përfshijnë të drejta të tjera të autorit dhe të drejta të ngjashme.

Seksioni 5 – Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë.

a) Përveç rasteve kur licencuesi bie dakord ndryshe, deri në masën e lejuar, licencuesi ofron materialin e licencuar në formën që është dhe në formën e disponueshme, dhe nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci të çfarëdo lloji në lidhje me materialin e licencuar, qoftë të shprehur, të nënkuptuar, ligjor apo të ndonjë forme tjetër. Kjo përfshin, pa kufizim, garancitë e titullit, tregtueshmërisë, përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar, mosshkeljes së të drejtave të autorit, mungesës së defekteve

të fshehura ose të tjera, saktësisë ose pranisë ose mungesës së gabimeve, qofshin të njohura ose të dukshme. Në rastet kur deklarata e mohimeve të garancive nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, kjo deklaratë mohimi mund të mos zbatohet për ju.

b) Për aq sa është e mundur, në asnjë rast licencuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj jush për ndonjë teori ligjore (përfshirë, pa kufizim, neglizhencë) ose ndryshe për çdo humbje, kosto të drejtpërdrejtë, të veçantë, të tërthortë, të rastësishme, të rastësishme, ndëshkuese, shembullore ose të tjera, shpenzimet ose dëmet që rrjedhin nga kjo licencë publike ose përdorimi i materialit të licencuar, edhe nëse licencuesi është informuar për mundësinë e humbjeve, kostove, shpenzimeve ose dëmeve të tilla. Kur një kufizim i përgjegjësisë nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, ky kufizim mund të mos zbatohet për ju.

c) Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë të dhënë më sipër do të interpretohet në një mënyrë që, deri në masën e mundshme, të për afrojë kryesisht me një deklaratë mohimi tepër të qartë dhe heqje dorë nga të gjitha përgjegjësitë.

Seksioni 6 – Afati dhe ndërprerja

a) Kjo licencë publike zbatohet për gjithë afatin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të ngjashme të licencuara në këtë dokument. Megjithatë, nëse ju nuk arrini të pajtoheni me këtë licencë publike, atëherë të drejtat tuaja sipas kësaj licence publike ndërpriten menjëherë.

b) Kur e drejta juaj për të përdorur materialin e licencuar ka përfunduar sipas seksionit 6(a), ajo ripërcaktohet:

1. automatikisht në datën kur shkelja korrigjohet, me kusht që të korrigjohet brenda 30 ditëve pas zbulimit të shkeljes të kryer nga ana juaj; ose

2. pas ripërcaktimit të miratuar nga licencuesi.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni 6(b) nuk prek asnjë të drejtë që licencuesi mund të ketë në kërkimin e mjeteve juridike për shkeljet e kryera nga ju të kësaj licence publike.

c) Për të shmangur çdo paqartësi, licencuesi mund ta ofrojë gjithashtu materialin e licencuar sipas termave ose kushteve të veçanta ose të ndalojë shpërndarjen e materialit të licencuar në çdo kohë; megjithatë, ky veprim nuk nënkupton ndërprerjen e kësaj licence publike.

d) Seksionet 1, 5, 6, 7 dhe 8 mbeten në fuqi pas ndërprerjes së kësaj licence publike.

Seksioni 7 – Terma dhe kushtet e tjera

a) Licencuesi nuk është i detyruar nga ndonjë term ose kusht tjetër shtesë ose të ndryshëm që i komunikohet nga Ju, përveç rasteve kur bihet dakord shprehimisht.

b) Çdo planifikim, perceptim ose marrëveshje në lidhje me materialin e licencuar që nuk përmendet këtu është e veçantë dhe e pavarur nga termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

Seksioni 8 – Interpretimi

a) Për të shmangur çdo paqartësi, kjo licencë publike nuk interpretohet dhe nuk do të interpretohet për të reduktuar, kufizuar ose vendosur kushte për ndonjë përdorim të materialit të licencuar që mund të bëhet ligjërish pa leje sipas kësaj licence publike.

b) Deri në masën e lejueshme, nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence publike konsiderohet e pazbatueshme, ajo do të korrigjohet menjëherë në masën minimale të nevojshme për ta bërë atë të zbatueshme. Nëse dispozita nuk mund të korrigjohet, ajo do të shkëputet nga kjo licencë publike pa prekur zbatueshmërinë e termave dhe kushteve të mbetura.

c) Asnjë term ose kusht i kësaj licence publike nuk do të hiqet dhe nuk do të jepet pëlqimi për asnjë mospërputhje, përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht nga licencuesi.

d) Nuk ka asgjë në këtë licencë publike nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si kufizim ose heqje dorë nga çdo privilegj dhe imunitet që zbatohet për licencuesin ose për ju, duke përfshirë dhe ato që rrjedhin nga proceset ligjore të çdo juridiksioni ose autoriteti.

Rreth Creative Commons

Creative Commons nuk është palë në licencat e saj publike. Megjithatë, Creative Commons mund të zgjedhë të aplikojë një nga licencat e saj publike për materialin që publikon dhe në ato raste do të konsiderohet “Licencuesi”. Teksti i licencave publike të Creative Commons i kushtohet domenit publik nën [CC0 Përkushtimi i Domenit Publik](#). Me përjashtim të qëllimit të kufizuar për të treguar se materiali shpërndahet nën një licencë publike Creative Commons ose siç lejohet ndryshe nga politikat Creative Commons të publikuara në creativecommons.org/policies, Creative Commons nuk autorizon përdorimin e markës tregtare “Creative Commons” ose ndonjë

marke tjetër tregtare ose logoje të Creative Commons pa pëlqimin e saj paraprak me shkrim, duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me çdo modifikim të paautorizuar në ndonjë nga licencat e saj publike ose ndonjë rregullim tjetër, mirëkuptim ose marrëveshje në lidhje me përdorimin e materialit të licencuar. Për të shmangur çdo dyshim, ky paragraf nuk bën pjesë në licencat publike.

Creative Commons mund të kontaktohet në creativecommons.org.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

Licenca CC BY-NC-SA 4.0 Atribuimi-Jokomercial-Ndani të Ngjashmet 4.0 Ndërkombëtar

Shih kodin ligjor

Ju jeni të lirë të:

Ndani – kopjoni dhe rishpërndani materialin në çfarëdo mediumi apo formati.

Përshtatni – ripërzieni, transformoni dhe ndërtoni mbi një material.

Licencuesi nuk mund t'i revokojë këto liri për sa kohë që ju zbatoni kushtet e licencës.

Sipas kushteve të mëposhtme:

Atribuimi – Duhet të jepni *kreditin e duhur*, të jepni një *link* për licencën dhe të *tregoni nëse janë bërë ndryshime*. Ju mund ta bëni këtë në çfarëdo mënyre të arsyeshme, por në asnjë mënyrë e cila sugjeron që licencuesi ju miraton ju ose miraton përdorimin tuaj.

Jokomerciale – Ju nuk mund ta përdorni materialin për *qëllime komerciale*.

Ndani të ngjashme – Nëse ripërzieni, transformoni ose ndërtoni mbi materialin, duhet t'i shpërndani kontributet tuaja nën të *njëjtën licencë* si origjinali.

Asnjë kufizim shtesë – Nuk mund të aplikoni terma ligjorë ose *masa teknologjike* që i kufizojnë ligjërisht të tjerët të bëjnë gjithçka që lejon licenca.

Njoftimet:

Ju nuk jeni të detyruar të pajtoheni me licencën për elemente të materialit në domenin publik ose kur përdorimi juaj lejohet nga një *përylashtim ose kufizim* i zbatueshëm.

Nuk jepen garanci. Licenca mund të mos ju japë të gjitha lejet e nevojshme për përdorimin tuaj të synuar. Për shembull, të drejta të tjera si *publiciteti, privatësia ose të drejtat morale* mund të kufizojnë mënyrën se si e përdorni materialin.

Shënimet në fund të faqes

Kredit i duhur – Nëse jepen, *duhet të jepni emrin e krijuesit dhe palët e atribuimit, një njoftim për të drejtën e autorit, një njoftim licence, një njoftim për mohimin e përgjegjësisë dhe një link për materialin. Licencat CC para versionit 4.0 kërkojnë gjithashtu që të jepni titullin e materialit nëse ofrohet dhe mund të ketë dallime të tjera të vogla.*

tregoni nëse janë bërë ndryshime – Në 4.0, *duhet të tregoni nëse keni modifikuar materialin dhe të mbani një tregues të modifikimeve të mëparshme. Në versionet 3.0 dhe versionet e mëparshme të licencës, tregimi i ndryshimeve kërkohet vetëm nëse krijoni një derivat.*

qëllime komerciale – *Një përdorim komercial është ai që synohet kryesisht për përfitim komercial ose kompensim monetar.*

të njëjtën licencë – *Ju gjithashtu mund të përdorni një licencë të listuar sit ë përputhshme në <https://creativecommons.org/compatiblelicenses>*

masat teknologjike – *Licenca ndalon zbatimin e masave efektive teknologjike, të përcaktuara duke iu referuar nenit 11 të Traktatit të së Drejtës së Autorit WIPO.*

përylashtimi ose kufizimi – *Të drejtat e përdoruesve sipas përylashtimeve dhe kufizimeve, të tilla si përdorimi i drejtë dhe trajtimi i drejtë, nuk preken nga licencat e CC.*

publiciteti, privatësia ose të drejtat morale – *Mund t'ju duhet të merrni leje shtesë përpara se ta përdorni materialin siç e keni qëllim.*

Njoftim

Ky akt nënvizon vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet kryesore të licencës aktuale. Nuk është licencë dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Ju duhet të rishikoni me kujdes të gjitha termat dhe kushtet e licencës aktuale përpara se të përdorni materialin e licencuar.

Creative Commons nuk është një firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore. Shpërndarja, shfaqja ose lidhja me këtë akt ose licencën që ai përmbledh nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

KODI LIGJOR I CC BY-NC-SA 4.0

Atribuimi – Jokomercial – Ndani të ngjashme 4.0 Ndërkombëtar

Rreth licencës dhe Creative Commons

Korporata Creative Commons (“Creative Commons”) nuk është firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore apo këshilla ligjore. Shpërndarja e licencave publike Creative Commons nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Creative Commons i bën të disponueshme licencat e saj dhe informacionin përkatës mbi bazën “ashtu siç është”. Creative Commons nuk jep asnjë garanci në lidhje me licencat e saj, as material të licencuar sipas termave dhe kushteve të tyre, ose ndonjë informacion të lidhur. Creative Commons mohon të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i tyre në masën më të plotë të mundshme.

Përdorimi i licencave publike të Creative Commons

Licencat publike Creative Commons ofrojnë një grup standard termash dhe kushtesh që krijuesit dhe ata që gëzojnë të drejtat mund të përdorin për të ndarë veprat origjinale të autorësisë dhe materiale të tjera që i nënshtrohen së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të specifikuar në licencën publike më poshtë. Konsideratat e mëposhtme janë vetëm për qëllime informative, nuk janë shteruese dhe nuk janë pjesë e licencave tona.

Konsiderata për licencuesit

Licencat tona publike janë të destinuar për t’u përdorur nga personat e autorizuar për të dhënë leje publikut për të përdorur materiale në mënyra të cilat në raste të tjera janë të kufizuara nga e drejta e autorit dhe disa të drejta të tjera. Licencat tona janë të parevokueshme. Licencuesit duhet të lexojnë dhe kuptojnë termat dhe kushtet e licencës që ata zgjedhin përpara se ta aplikojnë atë. Licencuesit duhet gjithashtu të sigurojnë të gjitha të drejtat e nevojshme përpara se të aplikojnë licencat tona në mënyrë që publiku të mund të ripërdorë materialin siç pritej. Licencuesit duhet të shënojnë qartë çdo material që nuk i nënshtrohet licencës. Kjo përfshin materiale të tjera të licencuara nga CC, ose materiale të përdorura sipas një përjashtimi ose kufizimi të së drejtës së autorit. [Më shumë konsiderata për licencuesit.](#)

Konsiderata për publikun

Duke përdorur një nga licencat tona publike, një licencues i jep publikut lejen për të përdorur materialin e licencuar sipas termave dhe kushteve të specifikuar. Nëse leja e licencuesit nuk është e nevojshme për ndonjë arsye – për shembull, për shkak të ndonjë përjashtimi ose kufizimi të zbatueshëm për të drejtën e autorit – atëherë ky përdorim nuk rregullohet nga licenca. Licencat tona japin vetëm leje sipas së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera që një licencues ka autoritetin t’i japë. Përdorimi i materialit të licencuar mund të jetë ende i kufizuar për arsye të tjera, duke përfshirë shkakun se persona të tjerë kanë të drejta të autorit ose të drejta të tjera në material. Një licencues mund të bëjë kërkesa të veçanta, si p.sh. të kërkojë që të gjitha ndryshimet të shënohen ose përshkruhen. Edhe pse nuk kërkohet nga licencat tona, ju inkurajojmë t’i respektoni ato kërkesa aty ku është e arsyeshme. [Më shumë konsiderata për publikun.](#)

Atribuimi-Jokomercial-Ndani të ngjashme 4.0 Ndërkombëtar

Duke ushtruar të drejtat e licencuara (të përcaktuara më poshtë), ju pranoni dhe bini dakord të zbatoni termat dhe kushtet e kësaj licence publike ndërkombëtare atribuimi-jokomercial-ndani të ngjashme 4.0 të Creative Commons (“Licencë publike”).

Në masën që kjo licencë publike mund të interpretohet si një kontratë, juve ju jepen të drejtat e licencuara duke marrë parasysh pranimin nga ana juaj të këtyre termave dhe kushteve dhe licencuesi ju jep këto të drejta duke marrë parasysh përfitimet që licencuesi merr nga vënia në dispozicion e materialit të licencuar sipas këtyre termave dhe kushteve.

Seksioni 1 – Përkufizime.

a) Materiali i përshtatur do të thotë material që i nënshtrohet së drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme që rrjedh nga ose bazohet në materialin e licencuar dhe në të cilin materiali i licencuar është përkthyer, ndryshuar, rregulluar, transformuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë që parashikon marrjen e lejes sipas të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme që gëzon licencuesi. Për qëllimet e kësaj licence publike, ku materiali i licencuar është një vepër muzikore, performancë ose regjistrim zanor, materiali i përshtatur gjithmonë prodhohet kur materiali i licencuar sinkronizohet në marrëdhënie të kufizuar kohore me një imazh lëvizës.

b) Licenca e përshtatësit nënkupton licencën ju aplikoni për të drejtat tuaja të autorit dhe të drejtat e ngjashme në kontributet tuaja në materialin e përshtatur në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

c) BY-NC-SA licencë e përputhshme do të thotë një licencë e listuar në: creativecommons.org/compatiblelicenses, e miratuar nga Creative Commons e cila në thelb është ekuivalente e kësaj licence publike.

d) E drejta e autorit dhe të drejtat e ngjashme nënkupton të drejtat e autorit dhe/ose të drejta të ngjashme të lidhura ngushtë me të drejtën e autorit, duke përfshirë, pa kufizim, performancën, transmetimin, regjistrimin e zërit dhe të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis, pa marrë parasysh se si etiketohen ose kategorizohen të drejtat. Për qëllimet e kësaj licence publike, të drejtat e specifikuar në seksionin 2(b)(1)-(2) nuk janë të drejtat e autorit dhe të drejta të ngjashme.

e) Masat efektive teknologjike nënkuptojnë ato masa që, në mungesë të autoritetit të duhur, nuk mund të anashkalohen sipas ligjeve që përmbushin detyrimet sipas nenit 11 të Traktatit për të Drejtën e Autorit të WIPO-s miratuar më 20 dhjetor 1996 dhe/ose marrëveshjeve të ngjashme ndërkombëtare.

f) Përrjashtimet dhe kufizimet nënkuptojnë përdorimin e drejtë, trajtimin e drejtë dhe/ose çdo përrjashtim ose kufizim tjetër për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohet për përdorimin tuaj të materialit të licencuar.

g) Elementet e licencës nënkupton atributet e licencës të listuara në emrin e një licence publike të Creative Commons. Elementet e licencës të kësaj licence publike janë: atribuimi, jokomerciale dhe ndani të ngjashme.

h) Materiali i licencuar nënkupton veprën artistike ose letrare, bazën e të dhënave ose ndonjë material tjetër për të cilin licencuesi ka aplikuar për këtë licencë publike.

i) Të drejtat e licencuara nënkuptojnë të drejtat që iu janë dhënë juve, në përputhje me kushtet e kësaj licence publike, të cilat kufizohen në të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohen për përdorimin tuaj të materialit të licencuar dhe që licencuesi ka autoritetin për t'i licencuar.

j) Licencues nënkupton individin(ët) ose subjektin(et) që japin të drejta sipas kësaj licence publike.

k) Jokomerciale nënkupton që kryesisht nuk synohet ose nuk drejtohet drejt përfitimit komercial ose kompensimit monetar. Për qëllime të kësaj licence publike, shkëmbimi i materialit të licencuar për materiale të tjera që i nënshtrohen të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme me anë të ndarjes së dosjeve digjitale ose me anë të mjeteve të ngjashme është jokomercial me kusht që të mos ketë pagesë për kompensimin monetar në lidhje me këtë shkëmbim.

l) Shpërndarja nënkupton ofrimin e materialit për publikun me çdo mjet ose proces që kërkon leje sipas të drejtave të licencuara, të tilla si riprodhimi, shfaqja publike, performanca publike, shpërndarja, shpërndarja, komunikimi ose importimi, dhe bërjen e materialeve të disponueshme për publikun duke përfshirë mënyrat që anëtarët e publikut të mund të aksesojnë materialin nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre.

m) Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis nënkuptojnë të drejta të ndryshme nga e drejta e autorit që rrjedhin nga direktiva 96/9/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, të ndryshuara dhe/ose pasuese, si dhe të drejta të tjera thelbësisht ekuivalente kudo në botë.

n) Ju nënkupton individin ose subjektin që ushtron të drejtat e licencuara sipas kësaj licence publike. **Juaja** ka kuptim përkatës.

Seksioni 2 – Fushëveprimi

a) Dhënia e licencës

1. Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike, licencuesi iu jep Juve një licencë mbarëbotërore, pa honorarë, jo të nënlicencueshme, joekskluzive, të përvokueshme për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e licencuar:

A. Materiali i licencuar të prodhohet dhe të ndahet, tërësisht ose pjesërisht, vetëm për qëllime jokomerciale; dhe

B. Materiali i përshtatur të prodhohet, të riprodhohet, dhe të ndahet vetëm për qëllime jokomerciale.

2. Përjashtimet dhe kufizimet. Për të shmangur çdo paqartësi, kur përjashtimet dhe kufizimet zbatohen për përdorimin tuaj, kjo licencë publike nuk zbatohet dhe ju nuk është e nevojshme të respektoni kushtet e saj.

3. Afati. Afati i kësaj licence publike është specifikuar në seksionin [6\(a\)](#).

4. Mediat dhe formatet; modifikimet teknike të lejuara. Licencuesi ju autorizon të ushtroni të drejtat e licencuara në të gjitha mediat dhe formatet, qofshin të njohura ose të krijuara më pas, dhe të bëni modifikimet teknike të nevojshme për ta bërë këtë. Licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord të mos ushtrojë asnjë të drejtë ose autoritet për t'ju ndaluar të bëni modifikimet teknike të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencuara, duke përfshirë modifikimet teknike të nevojshme për të anashkaluar masat teknologjike efektive. Për qëllime të kësaj licence publike, thjesht duke bërë modifikime të autorizuara nga seksioni [2\(a\)\(4\)](#), nuk prodhon asnjëherë material të përshtatur.

5. Marrësit e tërthortë.

A. Ofertë nga licencuesi – Materiali i licencuar. Çdo marrës i Materialit të Licencuar merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara sipas termave dhe kushteve të kësaj licence publike.

B. Ofertë shtesë nga licencuesi – Materiali i përshtatur. Çdo marrës i materialit të përshtatur nga ju merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e përshtatur sipas kushteve të licencës së përshtatësit që ju aplikoni.

6. Nuk ka asnjë miratim. Asgjë në këtë licencë publike nuk përbën, ose nuk mund të interpretohet si leje për të pretenduar ose nënkuptuar që ju, ose që përdorimi i materialit të licencuar nga ana juaj është i lidhur, ose i sponsorizuar, miratuar, ose i është dhënë status zyrtar nga licencuesi ose të tjerët që janë caktuar për të marrë atribum, siç parashikohet në seksionin [3\(a\)\(1\)\(A\)\(i\)](#).

b) Të drejta të tjera

1. Të drejtat morale, të tilla si e drejta e integritetit, nuk janë të licencuara në këtë licencë publike, as të drejtat e publicitetit, privatësisë dhe/ose të drejta të tjera të ngjashme të personalitetit; megjithatë, deri në masën e lejuar, licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord që të mos ushtrojë asnjë nga këto të drejta të mbajtura nga licencuesi deri në masën e kufizuar të nevojshme që ju lejon ju të ushtroni të drejtat e licencuara, por jo në raste të tjera.

2. Të drejtat e patentës dhe markës tregtare nuk licencohen nga kjo licencë publike.

3. Për aq sa është e lejueshme, licencuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të mbledhur honorarë nga ju për ushtrimin e të drejtave të licencuara, qoftë drejtpërdrejt ose përmes një organizate përgjegjëse për menaxhimin e honorarëve sipas ndonjë skeme licencimi vullnetare ose të licencuar, statutore ose të detyrueshme. Në të gjitha rastet e tjera, licencuesi rezervon shprehimisht çdo të drejtë për të mbledhur këta honorarë.

Seksioni 3 – Kushtet e licencës

Ushtrimi i të drejtave të licencuara i nënshtrohet shprehimisht kushteve të mëposhtme.

a) Atribimi

1. Nëse ndani materialin e licencuar (përfshirë formën e modifikuar), duhet:

A) të ruani sa vijon nëse është marrë nga licencuesi me materialin e licencuar:

i. identifikimin e krijuesit(ve) të materialit të licencuar dhe të çdo personi tjetër të caktuar për të marrë atribut, në çdo mënyrë të arsyeshme të kërkuar nga licencuesi (duke përfshirë pseudonimin nëse është e përcaktuar);

ii. një njoftim për të drejtën e autorit;

iii. një njoftim që i referohet kësaj licence publike;

iv. një njoftim që i referohet deklaratës së mohimit të garancive;

v. një URI ose *hyperlink* me materialin e licencuar deri në masën e arsyeshme të mundshme;
B) të tregoni nëse e keni modifikuar materialin e licencuar dhe të ruani një tregues të çdo modifikimi të mëparshëm; dhe

C) të tregoni se materiali i licencuar është i licencuar sipas kësaj licence publike dhe të përfshini tekstin, ose URI-në ose *hyperlink*-un me këtë licencë publike.

2. Ju mund të përmbushni kushtet në seksionin [3\(a\)\(1\)](#) në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju shpërndani materialin e licencuar. Për shembull, mund të jetë e arsyeshme të përmbushni kushtet duke ofruar një URI ose *hyperlink* për një burim që përfshin informacionin e nevojshëm.

3. Nëse kërkohet nga licencuesi, ju duhet të hiqni çdo informacion të kërkuar nga seksioni [3\(a\)\(1\)\(A\)](#) në masën e arsyeshme të mundshme.

b) Ndani të ngjashme

Përveç kushteve në seksionin 3 (a), nëse ndani materialin e përshtatur që prodhoni, zbatohen gjithashtu kushtet e mëposhtme.

1) Licenca e përshtatësit që aplikoni duhet të jetë një licencë e Creative Commons me të njëjtat elemente licence, në këtë version ose më të ri, ose një licencë e përputhshme BY-NC-SA.

2) Ju duhet të përfshini tekstin, ose URI-në, ose hiperlink-un me licencën e përshtatësit që aplikoni. Ju mund ta plotësoni këtë kusht në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju ndani materialin e përshtatur.

3) Ju nuk mund të ofroni ose impononi terma ose kushte shtesë ose të ndryshme, as të aplikoni ndonjë masë teknologjike efektive për materialin e përshtatur që kufizon ushtrimin e të drejtave të dhëna sipas licencës së përshtatësit që ju aplikoni.

Seksioni 4 – Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis

Kur të drejtat e licencuara përfshijnë të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis që zbatohen për përdorimin nga ana juaj të materialit të licencuar:

a) për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [2\(a\)\(1\)](#) iu jep të drejtën për të nxjerrë, ripërdorur, riprodhuar dhe ndarë të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave vetëm për qëllime jokomerciale;

b) nëse përfshini të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave në një bazë të dhënash në të cilën ju keni të drejta të bazës së të dhënave Sui Generis, atëherë baza e të dhënave në të cilën ju keni të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis (por jo përmbajtjen e saj individuale) është material i përshtatur, duke përfshirë për qëllime të seksionit [3\(b\)](#); dhe

c) Ju duhet të respektoni kushtet e përcaktuara në seksionin [3\(a\)](#) nëse ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [4](#) plotëson, por nuk zëvendëson detyrimet tuaja sipas kësaj licence publike ku të drejtat e licencuara përfshijnë të drejta të tjera të autorit dhe të drejta të ngjashme.

Seksioni 5 – Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjesisë.

a) Përveç rasteve kur licencuesi bie dakord ndryshe, deri në masën e lejuar, Licencuesi ofron materialin e licencuar në formën që është dhe në formën e disponueshme, dhe nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci të çfarëdo lloji në lidhje me Materialin e Licencuar, qoftë të shprehur, të nënkuptuar, ligjor apo të ndonjë forme tjetër. Kjo përfshin, pa kufizim, garancitë e titullit, tregtueshmërisë, përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar, mosshkeljes së të drejtave të autorit, mungesës së defekteve të fshehura ose të tjera, saktësisë ose pranisë ose mungesës së gabimeve, qofshin të njohura ose të dukshme. Në rastet kur deklarata e mohimeve të garancive nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, kjo deklaratë mohimi mund të mos zbatohet për ju.

b) Për aq sa është e mundur, në asnjë rast licencuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj jush për ndonjë teori ligjore (përfshirë, pa kufizim, neglizhencë) ose ndryshe për çdo humbje, kosto të drejtpërdrejtë, të veçantë, të tërthortë, të rastësishme, të rastësishme, ndëshkuese, shembullore ose të tjera, shpenzimet ose dëmet që rrjedhin nga kjo licencë publike ose përdorimi i materialit të licencuar, edhe nëse licencuesi është informuar për mundësinë e humbjeve, kostove, shpenzimeve ose dëmeve të tilla. Kur një kufizim

i përgjegjësishë nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, ky kufizim mund të mos zbatohet për ju.

c) Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësishë të dhënë më sipër do të interpretohet në një mënyrë që, deri në masën e mundshme, të për afrojë kryesisht me një deklaratë mohimi tepër të qartë dhe heqje dorë nga të gjitha përgjegjësishë.

Seksioni 6 – Afati dhe ndërprerja

a) Kjo licencë publike zbatohet për gjithë afatin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të Ngjashme të licencuara në këtë dokument. Megjithatë, nëse ju nuk arrini të pajtoheni me këtë licencë publike, atëherë të drejtat tuaja sipas kësaj licence publike ndërpriten menjëherë.

b) Kur e drejta juaj për të përdorur materialin e licencuar ka përfunduar sipas seksionit 6(a), ajo ripërcaktohet:

1. automatikisht në datën kur shkelja korrigjohet, me kusht që të korrigjohet brenda 30 ditëve pas zbulimit të shkeljes të kryer nga ana juaj; ose

2. pas ripërcaktimit të miratuar nga licencuesi.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni

[6 \(b\)](#) nuk prek asnjë të drejtë që licencuesi mund të ketë në kërkimin e mjeteve juridike për shkeljet e kryera nga ju të kësaj licence publike.

c) Për të shmangur çdo paqartësi, licencuesi mund ta ofrojë gjithashtu materialin e licencuar sipas termave ose kushteve të veçanta ose të ndalojë shpërndarjen e materialit të licencuar në çdo kohë; megjithatë, ky veprim nuk nënkupton ndërprerjen e kësaj licence publike.

d) Seksionet [1](#), [5](#), [6](#), [7](#) dhe [8](#) mbeten në fuqi pas ndërprerjes së kësaj licence publike.

Seksioni 7 – Terma dhe kushtet e tjera

a) Licencuesi nuk është i detyruar nga ndonjë term ose kusht tjetër shtesë ose të ndryshëm që i komunikohet nga ju, përveç rasteve kur bihet dakord shprehimisht.

b) Çdo planifikim, perceptim ose marrëveshje në lidhje me materialin e licencuar që nuk përmendet këtu është e veçantë dhe e pavarur nga termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

Seksioni 8 – Interpretimi

a) Për të shmangur çdo paqartësi, kjo licencë publike nuk interpretohet dhe nuk do të interpretohet për të reduktuar, kufizuar ose vendosur kushte për ndonjë përdorim të materialit të licencuar që mund të bëhet ligjërish pa leje sipas kësaj licence publike.

b) Deri në masën e lejueshme, nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence publike konsiderohet e pazbatueshme, ajo do të korrigjohet menjëherë në masën minimale të nevojshme për ta bërë atë të zbatueshme. Nëse dispozita nuk mund të korrigjohet, ajo do të shkëputet nga kjo licencë publike pa prekur zbatueshmërinë e termave dhe kushteve të mbetura.

c) Asnjë term ose kusht i kësaj licence publike nuk do të hiqet dhe nuk do të jepet pëlqimi për asnjë mospërputhje, përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht nga licencuesi.

d) Nuk ka asgjë në këtë licencë publike nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si kufizim ose heqje dorë nga çdo privilegj dhe imunitet që zbatohet për licencuesin ose për ju, duke përfshirë dhe ato që rrjedhin nga proceset ligjore të çdo juridiksioni ose autoriteti.

Rreth Creative Commons

Creative Commons nuk është palë në licencat e saj publike. Megjithatë, Creative Commons mund të zgjedhë të aplikojë një nga licencat e saj publike për materialin që publikon dhe në ato raste do të konsiderohet “Licencuesi”. Teksti i licencave publike të Creative Commons i kushtohet domenit publik nën [CC0 Përkushtimi i Domenit Publik](#). Me përjashtim të qëllimit të kufizuar për të treguar se materiali shpërndahet nën një licencë publike Creative Commons ose siç lejohet ndryshe nga politikat Creative Commons të publikuara në creativecommons.org/policies, Creative Commons nuk autorizon përdorimin e markës tregtare “Creative Commons” ose ndonjë marke tjetër tregtare ose logoje të Creative Commons pa pëlqimin e saj paraprak me shkrim, duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me çdo modifikim të paautorizuar në ndonjë nga licencat e saj publike ose ndonjë rregullim tjetër, mirëkuptim ose marrëveshje në lidhje me përdorimin e materialit të licencuar. Për të shmangur çdo dyshim, ky paragraf nuk bën pjesë në licencat publike.

Creative Commons mund të kontaktohet në creativecommons.org.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

Ju jeni të lirë të:

Ndani – kopjoni dhe rishpërndani materialin në çfarëdo mediumi apo formati për çfarëdo qëllimi, madje edhe komercial.

Licencuesi nuk mund t'i revokojë këto liri për sa kohë që ju zbatoni kushtet e licencës.

Sipas kushteve të mëposhtme:

Atribuimi – Duhet të jepni *kreditin e duhur*, të jepni një *link* për licencën dhe të *tregoni nëse janë bërë ndryshime*. Ju mund ta bëni këtë në çfarëdo mënyre të arsyeshme, por në asnjë mënyrë e cila sugjeron që licencuesi ju miraton ju ose miraton përdorimin tuaj.

Jo derivate – Nëse *ripërzhieni, transformoni ose ndërtoni mbi* materialin, nuk mund ta shpërndani materialin e modifikuar.

Asnjë kufizim shtesë – Nuk mund të aplikoni terma ligjorë ose *masa teknologjike* që i kufizojnë ligjërisht të tjerët të bëjnë gjithçka që lejon licenca.

Njoftimet:

Ju nuk jeni të detyruar të pajtoheni me licencën për elemente të materialit në domenin publik ose kur përdorimi juaj lejohet nga një *përyjashtim ose kufizim* i zbatueshëm.

Nuk jepen garanci. Licenca mund të mos ju japë të gjitha lejet e nevojshme për përdorimin tuaj të synuar. Për shembull, të drejta të tjera si *publiciteti, privatësia ose të drejtat morale* mund të kufizojnë mënyrën se si e përdorni materialin.

Shënimet në fund të faqes

Kredit i duhur – Nëse jepen, duhet të jepni emrin e krijuesit dhe palët e atribuimit, një njoftim për të drejtën e autorit, një njoftim licence, një njoftim për mbimin e përgjegjësisë dhe një link për materialin. Licencat CC para versionit 4.0 kërkojnë gjithashtu që të jepni titullin e materialit nëse ofrohet dhe mund të ketë dallime të tjera të vogla.

tregoni nëse janë bërë ndryshime – Në 4.0, duhet të tregoni nëse keni modifikuar materialin dhe të mbani një tregues të modifikimeve të mëparshme. Në versionet 3.0 dhe versionet e mëparshme të licencës, tregimi i ndryshimeve kërkohet vetëm nëse krijoni një derivat.

ripërzhieni, transformoni ose ndërtoni mbi materialin – Thjesht ndryshimi i formatit nuk krijon kurrë një derivat.

masat teknologjike – Licenca ndalon zbatimin e masave efektive teknologjike, të përcaktuara duke in referuar nenit 11 të Traktatit të së Drejtës së Autorit WIPO.

përyjashtimi ose kufizimi – Të drejtat e përdoruesve sipas përyjashtimeve dhe kufizimeve, të tilla si përdorimi i drejtë dhe trajtimi i drejtë, nuk preken nga licencat e CC.

publiciteti, privatësia ose të drejtat morale – Mund t'ju duhet të merrni leje shtesë përpara se ta përdorni materialin siç e keni qëllim.

Njoftim

Ky akt nënvizon vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet kryesore të licencës aktuale. Nuk është licencë dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Ju duhet të rishikoni me kujdes të gjitha termat dhe kushtet e licencës aktuale përpara se të përdorni materialin e licencuar.

Creative Commons nuk është një firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore. Shpërndarja, shfaqja ose lidhja me këtë akt ose licencën që ai përmbledh nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

KODI LIGJOR I CC BY-ND 4.0

Atribuimi-Joderivat 4.0 Ndërkombëtar

Rreth licencës dhe Creative Commons

Korporata Creative Commons (“Creative Commons”) nuk është firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore apo këshilla ligjore. Shpërndarja e licencave publike Creative Commons nuk

krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Creative Commons i bën të disponueshme licencat e saj dhe informacionin përkatës mbi bazën “ashtu siç është”. Creative Commons nuk jep asnjë garanci në lidhje me licencat e saj, as material të licencuar sipas termave dhe kushteve të tyre, ose ndonjë informacion të lidhur. Creative Commons mohon të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i tyre në masën më të plotë të mundshme.

Përdorimi i licencave publike të Creative Commons

Licencat publike Creative Commons ofrojnë një grup standard termash dhe kushtesh që krijuesit dhe ata që gëzojnë të drejtat mund të përdorin për të ndarë veprat origjinale të autorësisë dhe materiale të tjera që i nënshtrohen së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të specifikuar në licencën publike më poshtë. Konsideratat e mëposhtme janë vetëm për qëllime informative, nuk janë shteruese dhe nuk janë pjesë e licencave tona.

Konsiderata për licencuesit

Licencat tona publike janë të destinuar për t’u përdorur nga personat e autorizuar për të dhënë leje publikut për të përdorur materiale në mënyra të cilat në raste të tjera janë të kufizuara nga e drejta e autorit dhe disa të drejta të tjera. Licencat tona janë të parevokueshme. Licencuesit duhet të lexojnë dhe kuptojnë termat dhe kushtet e licencës që ata zgjedhin përpara se ta aplikojnë atë. Licencuesit duhet gjithashtu të sigurojnë të gjitha të drejtat e nevojshme përpara se të aplikojnë licencat tona në mënyrë që publiku të mund të ripërdorë materialin siç pritej. Licencuesit duhet të shënojnë qartë çdo material që nuk i nënshtrohet licencës. Kjo përfshin materiale të tjera të licencuara nga CC, ose materiale të përdorura sipas një përjashtimi ose kufizimi të së drejtës së autorit. [Më shumë konsiderata për licencuesit.](#)

Konsiderata për publikun

Duke përdorur një nga licencat tona publike, një licencues i jep publikut lejen për të përdorur materialin e licencuar sipas termave dhe kushteve të specifikuar. Nëse leja e licencuesit nuk është e nevojshme për ndonjë arsye – për shembull, për shkak të ndonjë përjashtimi ose kufizimi të zbatueshëm për të drejtën e autorit – atëherë ky përdorim nuk rregullohet nga licenca. Licencat tona japin vetëm leje sipas së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera që një licencues ka autoritetin t’i japë. Përdorimi i materialit të licencuar mund të jetë ende i kufizuar për arsye të tjera, duke përfshirë shkakun se persona të tjerë kanë të drejta të autorit ose të drejta të tjera në material. Një licencues mund të bëjë kërkesa të veçanta, si p.sh. të kërkojë që të gjitha ndryshimet të shënohen ose përshkruhen. Edhe pse nuk kërkohet nga licencat tona, ju inkurajojmë t’i respektoni ato kërkesa aty ku është e arsyeshme. [Më shumë konsiderata për publikun.](#)

Atribuimi-Joderivat 4.0 Ndërkombëtar

Duke ushtruar të drejtat e licencuara (të përcaktuara më poshtë), ju pranoni dhe bini dakord të zbatoni termat dhe kushtet e kësaj licence publike ndërkombëtare atribuimi-jo derivat 4.0 të Creative Commons (“Licencë publike”).

Në masën që kjo licencë publike mund të interpretohet si një kontratë, juve ju jepen të drejtat e licencuara duke marrë parasysh pranimin nga ana juaj të këtyre termave dhe kushteve dhe licencuesi ju jep këto të drejta duke marrë parasysh përfitimet që licencuesi merr nga vënia në dispozicion e materialit të licencuar sipas këtyre termave dhe kushteve.

Seksioni 1 – Përkufizime

a) Materiali i përshtatur do të thotë material që i nënshtrohet së drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme që rrjedh nga ose bazohet në materialin e licencuar dhe në të cilin materiali i licencuar është përkthyer, ndryshuar, rregulluar, transformuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë që parashikon marrjen e lejes sipas të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme që gëzon licencuesi. Për qëllimet e kësaj licence publike, ku materiali i licencuar është një vepër muzikore, performancë ose regjistrim zanor, materiali i përshtatur gjithmonë prodhohet kur materiali i licencuar sinkronizohet në marrëdhënie të kufizuara kohore me një imazh lëvizës.

b) E drejta e autorit dhe të drejtat e ngjashme nënkupton të drejtat e autorit dhe/ose të drejta të ngjashme të lidhura ngushtë me të drejtën e autorit, duke përfshirë, pa kufizim, performancën, transmetimin, regjistrimin e zërit dhe të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis, pa marrë parasysh se si etiketohen ose kategorizohen të drejtat. Për qëllimet e kësaj licence publike, të drejtat e specifikuar në seksionin [2\(b\)\(1\)-\(2\)](#) nuk janë të drejtat e autorit dhe të drejta të ngjashme.

c) Masat efektive teknologjike nënkuptojnë ato masa që, në mungesë të autoritetit të duhur, nuk mund të anashkalohen sipas ligjeve që përmbushin detyrimet sipas nenit 11 të Traktatit për të Drejtën e Autorit të WIPO-s miratuar më 20 dhjetor 1996 dhe/ose marrëveshjeve të ngjashme ndërkombëtare.

d) Përjashtimet dhe kufizimet nënkuptojnë përdorimin e drejtë, trajtimin e drejtë dhe/ose çdo përjashtim ose kufizim tjetër për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohet për përdorimin tuaj të materialit të licencuar.

e) Materiali i licencuar nënkupton veprën artistike ose letrare, bazën e të dhënave ose ndonjë material tjetër për të cilin licencuesi ka aplikuar për këtë licencë publike.

f) Të drejtat e licencuara nënkuptojnë të drejtat që iu janë dhënë juve, në përputhje me kushtet e kësaj licence publike, të cilat kufizohen në të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohen për përdorimin tuaj të materialit të licencuar dhe që licencuesi ka autoritetin për t'i licencuar.

g) Licencues nënkupton individin(ët) ose subjektin(et) që japin të drejta sipas kësaj licence publike.

h) Shpërndarja nënkupton ofrimin e materialit për publikun me çdo mjet ose proces që kërkon leje sipas të drejtave të licencuara, të tilla si riprodhimi, shfaqja publike, performanca publike, shpërndarja, shpërndarja, komunikimi ose importimi, dhe bërjen e materialeve të disponueshme për publikun duke përfshirë mënyrat që anëtarët e publikut të mund të aksesojnë materialin nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre.

i) Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis nënkuptojnë të drejta të ndryshme nga e drejta e autorit që rrjedhin nga direktiva 96/9/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, të ndryshuara dhe/ose pasuese, si dhe të drejta të tjera thelbësisht ekuivalente kudo në botë.

j) Ju nënkupton individin ose subjektin që ushtron të drejtat e licencuara sipas kësaj licence publike. **Juaja** ka kuptim përkatës.

Seksioni 2 – Fushëveprimi

a) Dhënia e licencës

1. Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike, licencuesi iu jep juve një licencë mbarëbotërore, pa honorarë, jo të nënlicencueshme, joekskluzive, të parevokueshme për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e licencuar:

A. Riprodhimi dhe shpërndarja e materialit të licencuar, tërësisht ose pjesërisht; dhe

B. prodhimi dhe riprodhimi, por jo ndarja e materialit të përshtatur.

2. **Përjashtimet dhe kufizimet.** Për të shmangur çdo paqartësi, kur përjashtimet dhe kufizimet zbatohen për përdorimin tuaj, kjo licencë publike nuk zbatohet dhe ju nuk është e nevojshme të respektoni kushtet e saj.

3. **Afati.** Afati i kësaj licence publike është specifikuar në seksionin [6 \(a\)](#).

4. **Mediat dhe formatet; modifikimet teknike të lejuara.** Licencuesi ju autorizon të ushtroni të drejtat e licencuara në të gjitha mediat dhe formatet, qofshin të njohura ose të krijuara më pas, dhe të bëni modifikimet teknike të nevojshme për ta bërë këtë. Licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord të mos ushtrojë asnjë të drejtë ose autoritet për t'ju ndaluar të bëni modifikimet teknike të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencuara, duke përfshirë modifikimet teknike të nevojshme për të anashkaluar masat teknologjike efektive. Për qëllime të kësaj licence publike, thjesht duke bërë modifikime të autorizuara nga seksioni 2(a)(4), nuk prodhon asnjëherë material të përshtatur.

5. Marrësit e tërthortë.

A. Ofertë nga licencuesi – materiali i licencuar. Çdo marrës i materialit të licencuar merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara sipas termave dhe kushteve të kësaj licence publike.

B. Nuk ka kufizime për marrësit e tërthortë. Ju nuk mund të ofroni apo të impononi asnjë term apo kusht shtesë ose të ndryshëm, ose të aplikoni ndonjë masë efektive teknologjike në materialin e licencuar, nëse kjo kufizon ushtrimin e të drejtave të licencuara nga ndonjë prej përfituesve të materialit të licencuar.

6. Nuk ka asnjë miratim. Asgjë në këtë licencë publike nuk përbën, ose nuk mund të interpretohet si leje për të pretenduar ose nënkuptuar që ju, ose që përdorimi i materialit të

licencuar nga ana Juaj është i lidhur, ose i sponsorizuar, miratuar, ose i është dhënë status zyrtar nga licencuesi ose të tjerët që janë caktuar për të marrë atribuin, siç parashikohet në seksionin [3\(a\)\(1\)\(A\)\(i\)](#).

b) Të drejta të tjera

1. Të drejtat morale, të tilla si e drejta e integritetit, nuk janë të licencuara në këtë licencë publike, as të drejtat e publicitetit, privatësisë dhe/ose të drejta të tjera të ngjashme të personalitetit; megjithatë, deri në masën e lejuar, licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord që të mos ushtrojë asnjë nga këto të drejta të mbajtura nga licencuesi deri në masën e kufizuar të nevojshme që ju lejon ju të ushtroni të drejtat e licencuara, por jo në raste të tjera.

2. Të drejtat e patentës dhe markës tregtare nuk licencohen nga kjo licencë publike.

3. Për aq sa është e lejueshme, licencuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të mbledhur honorarë nga ju për ushtrimin e të drejtave të licencuara, qoftë drejtpërdrejt ose përmes një organizate përgjegjëse për menaxhimin e honorarëve sipas ndonjë skeme licencimi vullnetare ose të licencuar, statutore ose të detyrueshme. Në të gjitha rastet e tjera, licencuesi rezervon shprehimisht çdo të drejtë për të mbledhur këta honorarë.

Seksioni 3 – Kushtet e licencës

Ushtrimi i të drejtave të licencuara i nënshtrohet shprehimisht kushteve të mëposhtme.

a) Atribuimi

1. Nëse ndani materialin e licencuar, ju duhet:

A. të ruani sa vijon nëse është marrë nga licencuesi me materialin e licencuar:

i. identifikimin e krijuesit(ve) të materialit të licencuar dhe të çdo personi tjetër të caktuar për të marrë atribut, në çdo mënyrë të arsyeshme të kërkuar nga licencuesi (duke përfshirë pseudonimin nëse është e përcaktuar);

ii. një njoftim për të drejtën e autorit;

iii. një njoftim që i referohet kësaj licence publike;

iv. një njoftim që i referohet deklaratës së mohimit të garancive;

v. një URI ose *hyperlink* me materialin e licencuar deri në masën e arsyeshme të mundshme;

B. të tregoni nëse e keni modifikuar materialin e licencuar dhe të ruani një tregues të çdo modifikimi të mëparshëm; dhe

C. të tregoni se materiali i licencuar është i licencuar sipas kësaj licence publike dhe të përfshini tekstin, ose URI-në ose *hyperlink*-un me këtë licencë publike.

Për shmangien e dyshimit, Ju nuk keni leje sipas kësaj licence publike për të ndarë materiale të përshtatura.

2. Ju mund të përmbushni kushtet në seksionin [3\(a\)\(1\)](#) në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju shpërndani materialin e licencuar. Për shembull, mund të jetë e arsyeshme të përmbushni kushtet duke ofruar një URI ose *hyperlink* për një burim që përfshin informacionin e nevojshëm.

3. Nëse kërkohet nga licencuesi, ju duhet të hiqni çdo informacion të kërkuar nga seksioni [3\(a\)\(1\)\(A\)](#) në masën e arsyeshme të mundshme.

Seksioni 4 – Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis

Kur të drejtat e licencuara përfshijnë të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis që zbatohen për përdorimin nga ana juaj të materialit të licencuar:

a) për të shmangur çdo dyshim, seksioni 2(a)(1) ju jep të drejtën për të nxjerrë, ripërdorur, riprodhuar dhe ndarë të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave, me kusht që të mos ndani materiale të përshtatura;

b) nëse përfshini të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave në një bazë të dhënash në të cilën ju keni të drejta të bazës së të dhënave Sui Generis, atëherë baza e të dhënave në të cilën ju keni të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis (por jo përmbajtjen e saj individuale) është material i përshtatur; dhe

c) Ju duhet të respektoni kushtet e përcaktuara në seksionin [3\(a\)](#) nëse ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni 4 plotëson, por nuk zëvendëson detyrimet tuaja sipas kësaj licence publike ku të drejtat e licencuara përfshijnë të drejta të tjera të autorit dhe të drejta të ngjashme.

Seksioni 5 – Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë

a) Përveç rasteve kur licencuesi bie dakord ndryshe, deri në masën e lejuar, licencuesi ofron materialin e licencuar në formën që është dhe në formën e disponueshme, dhe nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci të çfarëdo lloji në lidhje me Materialin e Licencuar, qoftë të shprehur, të nënkuptuar, ligjor apo të ndonjë forme tjetër. Kjo përfshin, pa kufizim, garancitë e titullit, tregtueshmërisë, përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar, mosshkeljes së të drejtave të autorit, mungesës së defekteve të fshehura ose të tjera, saktësisë ose pranisë ose mungesës së gabimeve, qofshin të njohura ose të dukshme. Në rastet kur deklarata e mohimeve të garancive nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, kjo deklaratë mohimi mund të mos zbatohet për ju.

b) Për aq sa është e mundur, në asnjë rast licencuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj jush për ndonjë teori ligjore (përfshirë, pa kufizim, neglizhencë) ose ndryshe për çdo humbje, kosto të drejtpërdrejtë, të veçantë, të tërthortë, të rastësishme, të rastësishme, ndëshkuese, shembullore ose të tjera, shpenzimet ose dëmet që rrjedhin nga kjo licencë publike ose përdorimi i materialit të licencuar, edhe nëse licencuesi është informuar për mundësinë e humbjeve, kostove, shpenzimeve ose dëmeve të tilla. Kur një kufizim i përgjegjësisë nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, ky kufizim mund të mos zbatohet për ju.

c) Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë të dhënë më sipër do të interpretohet në një mënyrë që, deri në masën e mundshme, të për afrojë kryesisht me një deklaratë mohimi tepër të qartë dhe heqje dorë nga të gjitha përgjegjësitë.

Seksioni 6 – Afati dhe ndërprerja

a) Kjo licencë publike zbatohet për gjithë afatin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të ngjashme të licencuara në këtë dokument. Megjithatë, nëse ju nuk arrini të pajtoheni me këtë licencë publike, atëherë të drejtat tuaja sipas kësaj licence publike ndërpriten menjëherë.

b) Kur e drejta juaj për të përdorur materialin e licencuar ka përfunduar sipas seksionit 6(a), ajo ripërcaktohet:

1. automatikisht në datën kur shkelja korrigjohet, me kusht që të korrigjohet brenda 30 ditëve pas zbulimit të shkeljes të kryer nga ana juaj; ose

2. pas ripërcaktimit të miratuar nga licencuesi.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [6 \(b\)](#) nuk prek asnjë të drejtë që licencuesi mund të ketë në kërkimin e mjeteve juridike për shkeljet e kryera nga ju të kësaj licence publike.

c) Për të shmangur çdo paqartësi, licencuesi mund ta ofrojë gjithashtu materialin e licencuar sipas termave ose kushteve të veçanta ose të ndalojë shpërndarjen e materialit të licencuar në çdo kohë; megjithatë, ky veprim nuk nënkupton ndërprerjen e kësaj licence publike.

d) Seksionet [1](#), [5](#), [6](#), [7](#) dhe [8](#) mbeten në fuqi pas ndërprerjes së kësaj licence publike.

Seksioni 7 – Terma dhe kushtet e tjera

a) Licencuesi nuk është i detyruar nga ndonjë term ose kusht tjetër shtesë ose të ndryshëm që i komunikohet nga ju, përveç rasteve kur bihet dakord shprehimisht.

b) Çdo planifikim, perceptim ose marrëveshje në lidhje me materialin e licencuar që nuk përmendet këtu është e veçantë dhe e pavarur nga termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

Seksioni 8 – Interpretimi

a) Për të shmangur çdo paqartësi, kjo licencë publike nuk interpretohet dhe nuk do të interpretohet për të reduktuar, kufizuar ose vendosur kushte për ndonjë përdorim të materialit të licencuar që mund të bëhet ligjërisht pa leje sipas kësaj licence publike.

b) Deri në masën e lejueshme, nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence publike konsiderohet e pazbatueshme, ajo do të korrigjohet menjëherë në masën minimale të nevojshme për ta bërë atë të zbatueshme. Nëse dispozita nuk mund të korrigjohet, ajo do të shkëputet nga kjo licencë publike pa prekur zbatueshmërinë e termave dhe kushteve të mbetura.

c) Asnjë term ose kusht i kësaj licence publike nuk do të hiqet dhe nuk do të jepet pëlqimi për asnjë mospërputhje, përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht nga licencuesi.

d) Nuk ka asgjë në këtë licencë publike nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si kufizim ose heqje dorë nga çdo privilegj dhe imunitet që zbatohet për licencuesin ose për ju, duke përfshirë dhe ato që rrjedhin nga proceset ligjore të çdo juridiksioni ose autoriteti.

Creative Commons nuk është palë në licencat e saj publike. Megjithatë, Creative Commons mund të zgjedhë të aplikojë një nga licencat e saj publike për materialin që publikon dhe në ato raste do të konsiderohet “Licencuesi”. Teksti i licencave publike të Creative Commons i kushtohet domenit publik nën [CC0 Përkushtimi i Domenit Publik](#). Me përjashtim të qëllimit të kufizuar për të treguar se materiali shpërndahet nën një licencë publike Creative Commons ose siç lejohet ndryshe nga politikat Creative Commons të publikuara në [creativecommons.org/policies](#), Creative Commons nuk autorizon përdorimin e markës tregtare “Creative Commons” ose ndonjë marke tjetër tregtare ose logoje të Creative Commons pa pëlqimin e saj paraprak me shkrim, duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me çdo modifikim të paautorizuar në ndonjë nga licencat e saj publike ose ndonjë rregullim tjetër, mirëkuptim ose marrëveshje në lidhje me përdorimin e materialit të licencuar. Për të shmangur çdo dyshim, ky paragraf nuk bën pjesë në licencat publike.

Creative Commons mund të kontaktohet në [creativecommons.org](#).

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

Licenca CC BY-NC-ND 4.0 Atribuimi-Jokomercial-Jo derivat 4.0 Ndërkombëtar Shih kodin ligjor

Ju jeni të lirë të:

Ndani – kopjoni dhe rishpërndani materialin në çfarëdo mediumi apo formati.

Licencuesi nuk mund t’i rrevokojë këto liri për sa kohë që ju zbatoni kushtet e licencës.

Sipas kushteve të mëposhtme:

Atribuimi – Duhet të jepni *kreditin e duhur*, të jepni një link për licencën dhe të *tregoni nëse janë bërë ndryshime*. Ju mund ta bëni këtë në çfarëdo mënyre të arsyeshme, por në asnjë mënyrë e cila sugjeron që licencuesi ju miraton ju ose miraton përdorimin tuaj.

Jokomercial – Ju nuk mund ta përdorni materialin për *qëllime komerciale*.

Jo Derivat – Nëse *ripërziëni, transformoni ose ndërtoni mbi materialin*, nuk mund ta shpërndani materialin e modifikuar.

Asnjë kufizim shtesë – Nuk mund të aplikoni terma ligjorë ose *masa teknologjike* që i kufizojnë ligjërisht të tjerët të bëjnë gjithçka që lejon licenca.

Njoftimet:

Ju nuk jeni të detyruar të pajtoheni me licencën për elemente të materialit në domenin publik ose kur përdorimi juaj lejohet nga një *përjashtim ose kufizim* i zbatueshëm.

Nuk jepen garanci. Licenca mund të mos ju japë të gjitha lejet e nevojshme për përdorimin tuaj të synuar. Për shembull, të drejta të tjera, si: *publiciteti, privatësia ose të drejtat morale* mund të kufizojnë mënyrën se si e përdorni materialin.

Shënimet në fund të faqes

Kredit i duhur – Nëse jepen, duhet të jepni emrin e krijuesit dhe palët e atribuimit, një njoftim për të drejtën e autorit, një njoftim licence, një njoftim për mobimin e përgjegjësisë dhe një link për materialin. Licencat CC para versionit 4.0 kërkojnë gjithashtu që të jepni titullin e materialit nëse ofrohet dhe mund të ketë dallime të tjera të vogla.

tregoni nëse janë bërë ndryshime – Në 4.0, duhet të tregoni nëse keni modifikuar materialin dhe të mbani një tregues të modifikimeve të mëparshme. Në versionet 3.0 dhe versionet e mëparshme të licencës, tregimi i ndryshimeve kërkohet vetëm nëse krijoni një derivat.

qëllime komerciale – Një përdorim komercial është ai që synohet kryesisht për përfitim komercial ose kompensim monetar

ripërziëni, transformoni ose ndërtoni mbi materialin – Thjesht ndryshimi i formatit nuk krijon kurrë një derivat.

masat teknologjike – Licenca ndalon zbatimin e masave efektive teknologjike, të përcaktuara duke iu referuar nenit 11 të Traktatit të së Drejtës së Autorit WIPO.

përjashtimi ose kufizimi – Të drejtat e përdoruesve sipas përjashtimeve dhe kufizimeve, të tilla si përdorimi i drejtë dhe trajtimi i drejtë, nuk preken nga licencat e CC.

publiciteti, privatësia ose të drejtat morale— Mund t’ju duhet të merrni leje shtesë përpara se ta përdorni materialin siç e keni qëllim.

Njoftim

Ky akt nënvizon vetëm disa nga veçoritë dhe kushtet kryesore të licencës aktuale. Nuk është licencë dhe nuk ka asnjë vlerë ligjore. Ju duhet të rishikoni me kujdes të gjitha termat dhe kushtet e licencës aktuale përpara se të përdorni materialin e licencuar.

Creative Commons nuk është një firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore. Shpërndarja, shfaqja ose lidhja me këtë akt ose licencën që ai përmbledh nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

KODI LIGJOR I CC BY-NC-ND 4.0

Atribuimi-Jokomercial- Joderivat 4.0 Ndërkombëtar

Rreth licencës dhe Creative Commons

Korporata Creative Commons (“Creative Commons”) nuk është firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore apo këshilla ligjore. Shpërndarja e licencave publike Creative Commons nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient ose ndonjë marrëdhënie tjetër. Creative Commons i bën të disponueshme licencat e saj dhe informacionin përkatës mbi bazën “ashtu siç është”. Creative Commons nuk jep asnjë garanci në lidhje me licencat e saj, as material të licencuar sipas termave dhe kushteve të tyre, ose ndonjë informacion të lidhur. Creative Commons mohon të gjitha përgjegjësitë për dëmet që rezultojnë nga përdorimi i tyre në masën më të plotë të mundshme.

Përdorimi i licencave publike të Creative Commons

Licencat publike Creative Commons ofrojnë një grup standard termash dhe kushtesh që krijuesit dhe ata që gëzojnë të drejtat mund të përdorin për të ndarë veprat origjinale të autorësisë dhe materiale të tjera që i nënshtrohen së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera të specifikuar në licencën publike më poshtë. Konsideratat e mëposhtme janë vetëm për qëllime informative, nuk janë shteruese dhe nuk janë pjesë e licencave tona.

Konsiderata për licencuesit

Licencat tona publike janë të destinuar për t’u përdorur nga personat e autorizuar për të dhënë leje publikut për të përdorur materiale në mënyra të cilat në raste të tjera janë të kufizuara nga e drejta e autorit dhe disa të drejta të tjera. Licencat tona janë të parevokueshme. Licencuesit duhet të lexojnë dhe kuptojnë termat dhe kushtet e licencës që ata zgjedhin përpara se ta aplikojnë atë. Licencuesit duhet gjithashtu të sigurojnë të gjitha të drejtat e nevojshme përpara se të aplikojnë licencat tona në mënyrë që publiku të mund të ripërdorë materialin siç pritej. Licencuesit duhet të shënojnë qartë çdo material që nuk i nënshtrohet licencës. Kjo përfshin materiale të tjera të licencuara nga CC, ose materiale të përdorura sipas një përjashtimi ose kufizimi të së drejtës së autorit. [Më shumë konsiderata për licencuesit.](#)

Konsiderata për publikun

Duke përdorur një nga licencat tona publike, një licencues i jep publikut lejen për të përdorur materialin e licencuar sipas termave dhe kushteve të specifikuar. Nëse leja e licencuesit nuk është e nevojshme për ndonjë arsye – për shembull, për shkak të ndonjë përjashtimi ose kufizimi të zbatueshëm për të drejtën e autorit – atëherë ky përdorim nuk rregullohet nga licenca. Licencat tona japin vetëm leje sipas së drejtës së autorit dhe disa të drejta të tjera që një licencues ka autoritetin t’i japë. Përdorimi i materialit të licencuar mund të jetë ende i kufizuar për arsye të tjera, duke përfshirë shkakun se persona të tjerë kanë të drejta të autorit ose të drejta të tjera në material. Një licencues mund të bëjë kërkesa të veçanta, si p.sh. të kërkojë që të gjitha ndryshimet të shënohen ose përshkruhen. Edhe pse nuk kërkohet nga licencat tona, ju inkurajojmë t’i respektoni ato kërkesa aty ku është e arsyeshme. [Më shumë konsiderata për publikun.](#)

Atribuimi-Jokomercial-Jo Derivat 4.0 Ndërkombëtar

Duke ushtruar të drejtat e licencuara (të përcaktuara më poshtë), ju pranoni dhe bini dakord të zbatoni termat dhe kushtet e kësaj licence publike ndërkombëtare atribuimi-jokomercial-joderivat 4.0 të Creative Commons (“Licencë publike”).

Në masën që kjo licencë publike mund të interpretohet si një kontratë, juve ju jepen të drejtat e licencuara duke marrë parasysh pranimin nga ana juaj të këtyre termave dhe kushteve dhe licencuesi ju jep këto të drejta duke marrë parasysh përfitimet që licencuesi merr nga vënia në dispozicion e materialit të licencuar sipas këtyre termave dhe kushteve.

Seksioni 1 – Përkufizime

a) Materiali i përshtatur do të thotë material që i nënshtrohet së drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme që rrjedh nga ose bazohet në materialin e licencuar dhe në të cilin materiali i licencuar është përkthyer, ndryshuar, rregulluar, transformuar ose modifikuar në një mënyrë të tillë që parashikon marrjen e lejes sipas të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme që gëzon licencuesi. Për qëllimet e kësaj licence publike, ku materiali i licencuar është një vepër muzikore, performancë ose regjistrim zanor, materiali i përshtatur gjithmonë prodhohet kur materiali i licencuar sinkronizohet në marrëdhënie të kufizuar kohore me një imazh lëvizës.

b) E drejta e autorit dhe të drejtat e ngjashme nënkupton të drejtat e autorit dhe/ose të drejta të ngjashme të lidhura ngushtë me të drejtën e autorit, duke përfshirë, pa kufizim, performancën, transmetimin, regjistrimin e zërit dhe të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis, pa marrë parasysh se si etiketohen ose kategorizohen të drejtat. Për qëllimet e kësaj licence publike, të drejtat e specifikuar në seksionin 2(b)(1)-(2) nuk janë të drejtat e autorit dhe të drejta të ngjashme.

c) Masat efektive teknologjike nënkuptojnë ato masa që, në mungesë të autoritetit të duhur, nuk mund të anashkalohen sipas ligjeve që përmbushin detyrimet sipas nenit 11 të Traktatit për të Drejtën e Autorit të WIPO-s miratuar më 20 dhjetor 1996 dhe/ose marrëveshjeve të ngjashme ndërkombëtare.

d) Përrjashtimet dhe kufizimet nënkuptojnë përdorimin e drejtë, trajtimin e drejtë dhe/ose çdo përrjashtim ose kufizim tjetër për të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohet për përdorimin tuaj të materialit të licencuar.

e) Materiali i licencuar nënkupton veprën artistike ose letrare, bazën e të dhënave ose ndonjë material tjetër për të cilin licencuesi ka aplikuar për këtë licencë publike.

f) Të drejtat e licencuara nënkuptojnë të drejtat që iu janë dhënë juve, në përputhje me kushtet e kësaj licence publike, të cilat kufizohen në të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e ngjashme që zbatohen për përdorimin tuaj të materialit të licencuar dhe që licencuesi ka autoritetin për t'i licencuar.

g) Licencues nënkupton individin(ët) ose subjektin(et) që japin të drejta sipas kësaj licence publike.

h) Jokomerciale nënkupton që kryesisht nuk synohet ose nuk drejtohet drejt përfitimit komercial ose kompensimit monetar. Për qëllime të kësaj licence publike, shkëmbimi i materialit të licencuar për materiale të tjera që i nënshtrohen të drejtave të autorit dhe të drejtave të ngjashme me anë të ndarjes së dosjeve digjitale ose me anë të mjeteve të ngjashme është jokomercial me kusht që të mos ketë pagesë për kompensimin monetar në lidhje me këtë shkëmbim.

i) Shpërndarja nënkupton ofrimin e materialit për publikun me çdo mjet ose proces që kërkon leje sipas të drejtave të licencuara, të tilla si riprodhimi, shfaqja publike, performanca publike, shpërndarja, shpërndarja, komunikimi ose importimi, dhe bërjen e materialeve të disponueshme për publikun duke përfshirë mënyrat që anëtarët e publikut të mund të aksesojnë materialin nga një vend dhe në një kohë të zgjedhur individualisht prej tyre.

j) Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis nënkuptojnë të drejta të ndryshme nga e drejta e autorit që rrjedhin nga direktiva 96/9/KE e Parlamentit dhe Këshillit Evropian e datës 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, të ndryshuara dhe/ose pasuese, si dhe të drejta të tjera thelbësisht ekuivalente kudo në botë.

k) Ju nënkupton individin ose subjektin që ushtron të drejtat e licencuara sipas kësaj licence publike. **Juaja** ka kuptim përkatës.

Seksioni 2 – Fushëveprimi

a) Dhënia e licencës

1. Në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj licence publike, licencuesi iu jep juve një licencë mbarëbotërore, pa honorarë, jo të nënlicencueshme, joekskluzive, të parevokueshme për të ushtruar të drejtat e licencuara në materialin e licencuar:

A. Riprodhimi dhe shpërndarja e materialit të licencuar, tërësisht ose pjesërisht; vetëm për qëllime jokomerciale; dhe

B. Prodhimi dhe riprodhimi, por jo ndarja e materialeve të përshtatura vetëm për qëllime jokomerciale.

2. Përfshirjet dhe kufizimet. Për të shmangur çdo paqartësi, kur përfshirjet dhe kufizimet zbatohen për përdorimin tuaj, kjo licencë publike nuk zbatohet dhe ju nuk është e nevojshme të respektoni kushtet e saj.

3. Afati. Afati i kësaj licence publike është specifikuar në seksionin [6\(a\)](#).

4. Mediat dhe formatet; modifikimet teknike të lejuara. Licencuesi ju autorizon të ushtroni të drejtat e licencuara në të gjitha mediat dhe formatet, qofshin të njohura ose të krijuara më pas, dhe të bëni modifikimet teknike të nevojshme për ta bërë këtë. Licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord të mos ushtrojë asnjë të drejtë ose autoritet për t'ju ndaluar të bëni modifikimet teknike të nevojshme për të ushtruar të drejtat e licencuara, duke përfshirë modifikimet teknike të nevojshme për të anashkaluar masat teknologjike efektive. Për qëllime të kësaj licence publike, thjesht duke bërë modifikime të autorizuara nga seksioni [2\(a\)\(4\)](#), nuk prodhon asnjëherë material të përshtatur.

5. Marrësit që marrin të dhëna drejtpërdrejt ose tërthorazi.

A. Ofertë nga licencuesi – materiali i licencuar. Çdo marrës i materialit të licencuar merr automatikisht një ofertë nga licencuesi për të ushtruar të drejtat e licencuara sipas termave dhe kushteve të kësaj licence publike.

B. Nuk ka kufizime për marrësit e tërthortë. Ju nuk mund të ofroni apo të impononi asnjë term apo kusht shtesë ose të ndryshëm, ose të aplikoni ndonjë masë efektive teknologjike në materialin e licencuar, nëse kjo kufizon ushtrimin e të drejtave të licencuara nga ndonjë prej përfituesve të materialit të licencuar.

6. Nuk ka asnjë miratim. Asgjë në këtë licencë publike nuk përbën, ose nuk mund të interpretohet si leje për të pretenduar ose nënkuptuar që ju, ose që përdorimi i materialit të licencuar nga ana juaj është i lidhur, ose i sponsorizuar, miratuar, ose i është dhënë status zyrtar nga licencuesi ose të tjerët që janë caktuar për të marrë atribum, siç parashikohet në seksionin [3\(a\)\(1\)\(A\)\(i\)](#).

b) Të drejta të tjera

1. Të drejtat morale, të tilla si e drejta e integritetit, nuk janë të licencuara në këtë licencë publike, as të drejtat e publicitetit, privatësisë dhe/ose të drejta të tjera të ngjashme të personalitetit; megjithatë, deri në masën e lejuar, licencuesi heq dorë dhe/ose bie dakord që të mos ushtrojë asnjë nga këto të drejta të mbajtura nga licencuesi deri në masën e kufizuar të nevojshme që ju lejon ju të ushtroni të drejtat e licencuara, por jo në raste të tjera.

2. Të drejtat e patentës dhe markës tregtare nuk licencohen nga kjo licencë publike.

3. Për aq sa është e lejueshme, licencuesi heq dorë nga çdo e drejtë për të mbledhur honorarë nga ju për ushtrimin e të drejtave të licencuara, qoftë drejtpërdrejt ose përmes një organizate përgjegjëse për menaxhimin e honorarëve sipas ndonjë skeme licencimi vullnetare ose të licencuar, statutore ose të detyrueshme. në të gjitha rastet e tjera, licencuesi rezervon shprehimisht çdo të drejtë për t'i mbledhur këta honorarë, duke përfshirë rastin kur materiali i licencuar përdoret ndryshe nga qëllimet jokomerciale.

Seksioni 3 – Kushtet e licencës

Ushtrimi i të drejtave të licencuara i nënshtrohet shprehimisht kushteve të mëposhtme.

a) Atribuimi

1. Nëse ndani materialin e licencuar, duhet që:

A. të ruani sa vijon nëse është marrë nga licencuesi me materialin e licencuar:

i. identifikimin e krijuesit(ve) të materialit të licencuar dhe të çdo personi tjetër të caktuar për të marrë atribut, në çdo mënyrë të arsyeshme të kërkuar nga licencuesi (duke përfshirë pseudonimin nëse është e përcaktuar);

ii. një njoftim për të drejtën e autorit;

iii. një njoftim që i referohet kësaj licence publike;

iv. një njoftim që i referohet deklaratës së mohimit të garancive;

v. një URI ose *hyperlink* me materialin e licencuar deri në masën e arsyeshme të mundshme;

B. të tregoni nëse e keni modifikuar materialin e licencuar dhe të ruani një tregues të çdo modifikimi të mëparshëm; dhe

C. të tregoni se materiali i licencuar është i licencuar sipas kësaj licence publike dhe të përfshini tekstin, ose URI-në ose *hyperlink*-un me këtë licencë publike.

Për të shmangur çdo dyshim, ju nuk keni leje sipas kësaj licence publike për të ndarë materiale të përshtatura.

2. Ju mund të përmbushni kushtet në seksionin [3\(a\)\(1\)](#) në çdo mënyrë të arsyeshme bazuar në mediumin, mjetet dhe kontekstin në të cilin ju shpërndani materialin e licencuar. Për shembull, mund të jetë e arsyeshme të përmbushni kushtet duke ofruar një URI ose *hyperlink* për një burim që përfshin informacionin e nevojshëm.

3. Nëse kërkohet nga licencuesi, ju duhet të hiqni çdo informacion të kërkuar nga seksioni [3\(a\)\(1\)\(A\)](#) në masën e arsyeshme të mundshme.

Seksioni 4 – Të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis

Kur të drejtat e licencuara përfshijnë të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis që zbatohen për përdorimin nga ana juaj të materialit të licencuar:

a) për të shmangur çdo dyshim, seksioni [2\(a\)\(1\)](#) ju jep të drejtën për të nxjerrë, ripërdorur, riprodhuar dhe ndarë të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave vetëm për qëllime jokomerciale dhe me kusht që të mos shpërndani Materiale të Përshtatura;

b) nëse përfshini të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave në një bazë të dhënash në të cilën ju keni të drejta të bazës së të dhënave Sui Generis, atëherë baza e të dhënave në të cilën ju keni të drejtat e bazës së të dhënave Sui Generis (por jo përmbajtjen e saj individuale) është material i përshtatur; dhe

c) Ju duhet të respektoni kushtet e përcaktuara në seksionin [3\(a\)](#) nëse ndani të gjithë ose një pjesë të konsiderueshme të përmbajtjes së bazës së të dhënave.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [4](#) plotëson, por nuk zëvendëson detyrimet tuaja sipas kësaj licence publike ku të drejtat e licencuara përfshijnë të drejta të tjera të autorit dhe të drejta të ngjashme.

Seksioni 5 – Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë

a) **Përveç rasteve kur licencuesi bie dakord ndryshe, deri në masën e lejuar, licencuesi ofron materialin e licencuar në formën që është dhe në formën e disponueshme, dhe nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci të çfarëdo lloji në lidhje me materialin e licencuar, qoftë të shprehur, të nënkuptuar, ligjor apo të ndonjë forme tjetër. Kjo përfshin, pa kufizim, garancitë e titullit, tregtueshmërisë, përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar, mosshkeljes së të drejtave të autorit, mungesës së defekteve të fshehura ose të tjera, saktësisë ose pranisë ose mungesës së gabimeve, qofshin të njohura ose të dukshme. Në rastet kur deklarata e mohimeve të garancive nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, kjo deklaratë mohimi mund të mos zbatohet për ju.**

b) **Për aq sa është e mundur, në asnjë rast licencuesi nuk do të jetë përgjegjës ndaj jush për ndonjë teori ligjore (përfshirë, pa kufizim, neglizhencë) ose ndryshe për çdo humbje, kosto të drejtpërdrejtë, të veçantë, të tërthortë, të rastësishme, të rastësishme, ndëshkuese, shembullore ose të tjera, shpenzimet ose dëmet që rrjedhin nga kjo licencë publike ose përdorimi i materialit të licencuar, edhe nëse licencuesi është informuar për mundësinë e humbjeve, kostove, shpenzimeve ose dëmeve të tilla. Kur një kufizim i përgjegjësisë nuk lejohet plotësisht ose pjesërisht, ky kufizim mund të mos zbatohet për ju.**

c) Deklarata e mohimit të garancive dhe kufizimi i përgjegjësisë të dhënë më sipër do të interpretohet në një mënyrë që, deri në masën e mundshme, të për afrojë kryesisht me një deklaratë mohimi tepër të qartë dhe heqje dorë nga të gjitha përgjegjësitë.

Seksioni 6 – Afati dhe ndërprerja

a) Kjo licencë publike zbatohet për gjithë afatin e të drejtave të autorit dhe të të drejtave të ngjashme të licencuara në këtë dokument. Megjithatë, nëse ju nuk arrini të pajtoheni me këtë licencë publike, atëherë të drejtat tuaja sipas kësaj licence publike ndërpriten menjëherë.

b) Kur e drejta juaj për të përdorur materialin e licencuar ka përfunduar sipas seksionit 6(a), ajo ripërcaktohet:

1. automatikisht në datën kur shkelja korrigjohet, me kusht që të korrigjohet brenda 30 ditëve pas zbulimit të shkeljes të kryer nga ana juaj; ose

2. pas ripërcaktimit të miratuar nga licencuesi.

Për të shmangur çdo paqartësi, seksioni [6 \(b\)](#) nuk prek asnjë të drejtë që licencuesi mund të ketë në kërkimin e mjeteve juridike për shkeljet e kryera nga ju të kësaj licence publike.

c) Për të shmangur çdo paqartësi, licencuesi mund ta ofrojë gjithashtu materialin e licencuar sipas termave ose kushteve të veçanta ose të ndalojë shpërndarjen e materialit të licencuar në çdo kohë; megjithatë, ky veprim nuk nënkupton ndërprerjen e kësaj licence publike.

d) Seksionet [1](#), [5](#), [6](#), [7](#) dhe [8](#) mbeten në fuqi pas ndërprerjes së kësaj licence publike.

Seksioni 7 – Terma dhe kushtet e tjera

a) Licencuesi nuk është i detyruar nga ndonjë term ose kusht tjetër shtesë ose të ndryshëm që i komunikohet nga ju, përveç rasteve kur bihet dakord shprehimisht.

b) Çdo planifikim, perceptim ose marrëveshje në lidhje me materialin e licencuar që nuk përmendet këtu është e veçantë dhe e pavarur nga termat dhe kushtet e kësaj licence publike.

Seksioni 8 – Interpretimi

a) Për të shmangur çdo paqartësi, kjo licencë publike nuk interpretohet dhe nuk do të interpretohet për të reduktuar, kufizuar ose vendosur kushte për ndonjë përdorim të Materialit të Licencuar që mund të bëhet ligjërisht pa leje sipas kësaj licence publike.

b) Deri në masën e lejueshme, nëse ndonjë dispozitë e kësaj licence publike konsiderohet e pazbatueshme, ajo do të korrigjohet menjëherë në masën minimale të nevojshme për ta bërë atë të zbatueshme. Nëse dispozita nuk mund të korrigjohet, ajo do të shkëputet nga kjo licencë publike pa prekur zbatueshmërinë e termave dhe kushteve të mbetura.

c) Asnjë term ose kusht i kësaj licence publike nuk do të hiqet dhe nuk do të jepet pëlqimi për asnjë mospërputhje, përveç rasteve kur është rënë dakord shprehimisht nga licencuesi.

d) Nuk ka asgjë në këtë licencë publike nuk përbën dhe nuk mund të interpretohet si kufizim ose heqje dorë nga çdo privilegj dhe imunitet që zbatohet për licencuesin ose për ju, duke përfshirë dhe ato që rrjedhin nga proceset ligjore të çdo juridiksioni ose autoriteti.

Rreth Creative Commons

Creative Commons nuk është palë në licencat e saj publike. Megjithatë, Creative Commons mund të zgjedhë të aplikojë një nga licencat e saj publike për materialin që publikon dhe në ato raste do të konsiderohet “Licencuesi”. Teksti i licencave publike të Creative Commons i kushtohet domenit publik nën [CC0 Përkushtimi i Domenit Publik](#). Me përjashtim të qëllimit të kufizuar për të treguar se materiali shpërndahet nën një licencë publike Creative Commons ose siç lejohet ndryshe nga politikat Creative Commons të publikuara në creativecommons.org/policies, Creative Commons nuk autorizon përdorimin e markës tregtare “Creative Commons” ose ndonjë marke tjetër tregtare ose logoje të Creative Commons pa pëlqimin e saj paraprak me shkrim, duke përfshirë, pa kufizim, në lidhje me çdo modifikim të paautorizuar në ndonjë nga licencat e saj publike ose ndonjë rregullim tjetër, mirëkuptim ose marrëveshje në lidhje me përdorimin e materialit të licencuar. Për të shmangur çdo dyshim, ky paragraf nuk bën pjesë në licencat publike.

Creative Commons mund të kontaktohet në creativecommons.org.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

Licenca CC0 1.0 Universal

Shih kodin ligjor

Nuk ka të drejtë të autorit

Personi që ka lidhur një vepër me këtë akt, ia ka **kushtuar** veprën domenit publik duke hequr dorë nga të gjitha të drejtat e tij/saj për veprën në mbarë botën sipas ligjit të së drejtës së autorit, duke përfshirë të gjitha të drejtat e lidhura dhe fqinje, në masën e lejuar me ligj.

Ju mund të kopjoni, modifikoni, shpërndani dhe kryeni veprën, edhe për qëllime komerciale, të gjitha pa kërkuar leje. Shihni informacione të tjera më poshtë.

Informacione të tjera

Në asnjë mënyrë nuk preken të drejtat e patentës ose të markës tregtare të ndonjë personi nga CC0, as të drejtat që mund të kenë persona të tjerë në vepër ose në mënyrën se si përdoret vepra, të tilla si *publiciteti ose të drejtat e privatësisë*.

Përveç rasteve kur shprehimisht thuhet ndryshe, personi që ka lidhur një vepër me këtë akt nuk jep garanci për veprën dhe mohon përgjegjësinë për të gjitha përdorimet e veprës, në masën më të plotë të lejuar nga ligji në fuqi.

Kur përdorni ose citoni veprën, nuk duhet të nënkuptoni *miratimin* e publicitetit ose të privatësisë nga autori ose afirmuesi.

Shënimet në fund të faqes

publiciteti apo privatësia – Përdorimi i një vepre pa kufizime të njohura të së drejtës së autorit mund të rregullohet ose kufizohet ndryshe. Veptra ose përdorimi i saj mund t'i nënshtrohet ligjeve për mbrojtjen e të dhënave personale, publicitetit, imazhit ose të drejtave të privatësisë që lejojnë një person të kontrollojë se si përdoret zëri, imazhi ose ngjashmëria e tij, ose kufizime ose limite të tjera sipas ligjit në fuqi.

Miratimi – Në disa juridiksione, që të nënkuptosh gabimisht se një autor, botues ose dikush tjetër miraton përdorimin tuaj të një vepre mund të jetë e paligjshme.

Njoftim

Akti i Commons nuk është një instrument ligjor. Është thjesht një referencë e dobishme për të kuptuar Kodin Ligjor CC0, një shprehje e lexueshme nga personi i disa prej termave të tij kyç. Konsiderojeni si ndërfaqen miqësore për përdoruesit për Kodin Ligjor CC0 më poshtë. Vetë ky akt nuk ka vlerë ligjore dhe përmbajtja e tij nuk shfaqet në CC0.

Creative Commons nuk është një firmë ligjore dhe nuk ofron shërbime ligjore. Shpërndarja, shfaqja ose lidhja me këtë akt të Commons nuk krijon një marrëdhënie avokat-klient.

Creative Commons nuk e ka verifikuar statusin e së drejtës së autorit të ndonjë vepre për të cilën është aplikuar CC0. CC nuk jep asnjë garanci për ndonjë vepër ose statusin e saj të së drejtës së autorit në çdo juridiksion dhe mohon të gjitha përgjegjësitë për të gjitha përdorimet e çdo vepre.

Creative Commons është organizata jofitimprurëse që qëndron pas licencave të hapura dhe mjeteve të tjera ligjore që lejojnë krijuesit të ndajnë punën e tyre. Mjetet tona ligjore mund të përdoren falas.

KODI LIGJOR i CC0 1.0 Universal

CC0 1.0 Universal

KORPORATA CREATIVE COMMONS (“CREATIVE COMMONS”) NUK ËSHTË FIRMË LIGJORE DHE NUK OFRON SHËRBIME LIGJORE. SHPËRNDARJA E KËTIJ DOKUMENTI NUK KRIJON NJË MARRËDHËNIE AVOKAT-KLIENT. CREATIVE COMMONS E OFRON KËTË INFORMACION MBI BAZËN “ASHTU SIÇ ËSHTË”. CREATIVE COMMONS NUK JEP ASNJË GARANCI LIDHUR ME PËRDORIMIN E KËTIJ DOKUMENTI OSE INFORMACIONIT APO PUNËT E OFRUARA KËTU DHE MOHON PËRGJEGJËSINË PËR DËMET QË REZULTOJNË NGA PËRDORIMI I KËTIJ DOKUMENTI

Deklarata e qëllimit

Ligjet e shumicës së juridiksioneve në të gjithë botën i japin automatikisht Të drejtat ekskluzive të autorit dhe Të drejtat e ngjashme (të përcaktuara më poshtë) krijuesit dhe pronarit(ve) pasues (secilit dhe të gjithë, një “pronar”) të një vepre origjinale të autorësisë dhe/ose një bazë të dhënash (secili, një “Vepër”).

Disa pronarë dëshirojnë të heqin dorë përgjithmonë nga këto të drejta mbi një vepër me qëllim që të kontribuojnë në një të përbashkët të veprave krijuese, kulturore dhe shkencore (“Commons”) që publiku mund të mbështetet në mënyrë të besueshme dhe pa frikë nga pretendimet e mëvonshme për shkelje, për të ndërtuar mbi to, për t'i modifikuar, për t'i inkorporuar në vepra të tjera, për t'i ripërdorur dhe për t'i ripërhapur sa më lirshëm të jetë e mundur në çfarëdo forme dhe për çfarëdo qëllimi, duke përfshirë pa kufizim qëllimet komerciale. Këta pronarë mund të kontribuojnë në Commons për të promovuar idealin e një kulture të lirë dhe prodhimin e mëtejshëm të veprave krijuese, kulturore dhe shkencore, ose për të fituar reputacion ose shpërndarje më të madhe për veprën e tyre pjesërisht përmes përdorimit dhe përpjekjeve të të tjerëve.

Për këto dhe/ose qëllime dhe motivacione të tjera, dhe pa asnjë pritshmëri për konsideratë ose kompensim shtesë, personi që lidh CC0 me një vepër (“Afirmuesi”), në masën që ai ose ajo është pronar i të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura me një vepër, zgjedh vullnetarisht të aplikojë CC0 në vepër dhe ta shpërndajë publikisht veprën sipas kushteve të saj, duke u informuar për të drejtat e tij ose të saj të autorit dhe të drejtat e lidhura me veprën dhe kuptimin dhe efektin ligjor të synuar të CC0 mbi këto të drejta.

1. E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura me të

Një vepër e vënë në dispozicion sipas CC0 mund të mbrohet nga e drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura ose të ngjashme (“E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura”). E drejta e autorit dhe të drejtat e lidhura përfshijnë, por nuk kufizohen në, sa vijon:

- i. e drejta për të riprodhuar, përshtatur, shpërndarë, interpretuar, shfaqur, komunikuar dhe përkthyer një vepër;
- ii. të drejtat morale të ruajtura nga autori(ët) dhe/ose interpretuesi(ët) origjinal(ë);
- iii. të drejtat e publicitetit dhe privatësisë që kanë të bëjnë me imazhin ose ngjashmërinë e një personi të përshkruar në vepër;
- iv. të drejtat që ofrojnë mbrojtje kundër konkurrencës së pandershme në lidhje me një vepër, duke iu nënshtruar kufizimeve në paragrafin 4(a), më poshtë;
- v. të drejtat që mbrojnë nxjerrjen, shpërndarjen, përdorimin dhe ripërdorimin e të dhënave në një vepër;
- vi. të drejtat e bazës së të dhënave (të tilla si ato që rrjedhin nga direktiva 96/9/KE e Parlamentit dhe e Këshillit Evropian të datës 11 mars 1996 mbi mbrojtjen ligjore të bazave të të dhënave, dhe në bazë të çdo zbatimi kombëtar të saj, duke përfshirë çdo version të ndryshuar ose pasardhës të kësaj direktive); dhe
- vii. të drejta të tjera të ngjashme, ekuivalente ose korresponduese në mbarë botën bazuar në ligjet ose traktatet në fuqi, dhe çdo zbatim kombëtar të tyre.

2. Heqja dorë

Në masën më të madhe të lejuar nga, por jo në kundërshtim me ligjin në fuqi, afirmuesi në mënyrë të hapur, të plotë, përgjithmonë, në mënyrë të pakthyeshme dhe pa kushte heq dorë, braktis dhe dorëzon të gjitha të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura të afirmuesit, si dhe pretendimet dhe shkaqet e veprimit të lidhura me to, qofshin këto aktualisht të njohura ose të panjohura (duke përfshirë pretendimet ekzistuese, si dhe ato të ardhshme dhe shkaqet e veprimit), të veprës: (i) në të gjitha territoret në mbarë botën; (ii) për periudhën maksimale të parashikuar nga ligji ose traktati në fuqi (duke përfshirë kohëzgjatjen në të ardhmen; (iii) në çdo medium aktual ose të ardhshëm dhe për çdo numër kopjesh; dhe (iv) për çfarëdo lloj qëllimi, duke përfshirë pa kufizim qëllime komerciale, reklamuese ose promovuese (“Heqja dorë”). Afirmuesi heq dorë në të mirë të çdo anëtarit të publikut në përgjithësi dhe në dëm të trashëgimtarëve dhe pasardhësve të afirmuesit, me qëllim që kjo heqje dorë të mos i nënshtrohet revokimit, shfuqizimit, anulimit, ndërprerjes ose ndonjë veprimi tjetër ligjor ose të drejtë që prek kënaqësinë e veprës nga publiku, siç parashikohet nga deklaratata e qartë e qëllimit të afirmuesit.

3. Rikthim i licencës publike

Nëse për çfarëdo arsye, ndonjë pjesë e deklaratës së heqjes dorë vlerësohet ligjërisht e pavlefshme ose e paefektshme sipas ligjit në fuqi, atëherë heqja dorë do të ruhet në masën maksimale të lejuar duke marrë parasysh deklaratën e shprehur të qëllimit të afirmuesit. Për më tepër, në masën që heqja dorë vlerësohet kështu, afirmuesi i jep çdo personi të prekur një licencë pa honorarë, të patransferueshme, të panënllicencueshme, joekskluzive, të parevokueshme dhe të pakushtëzuar për të ushtruar të drejtat e autorit të afirmuesit dhe të drejtat e lidhura me veprën: (i) në të gjitha territoret në mbarë botën; (ii) për kohëzgjatjen maksimale të parashikuar nga ligji ose traktati në fuqi (duke përfshirë kohëzgjatjet e ardhshme); (iii) në çdo medium aktual ose të ardhshëm dhe për çdo numër kopjesh; dhe (iv) për çfarëdo lloj qëllimi, duke përfshirë pa kufizim, për qëllime komerciale, reklamuese ose promovuese (“Licenca”). Licenca do të konsiderohet efektive që nga data kur CC0 zbatohet nga afirmuesi në vepër. Nëse ndonjë pjesë e licencës për ndonjë arsye vlerësohet ligjërisht e pavlefshme ose e paefektshme sipas ligjit në fuqi, kjo pavlefshmëri ose paefektshmëri e pjeshme nuk do të zhvleftësojë pjesën e mbetur të licencës, dhe në këtë rast Afirmuesi deklaron se ai ose ajo nuk: (i) do të ushtrojë ndonjë nga të

drejtat e tij ose të saj të mbetura të autorit dhe të drejtat e lidhura me veprën; ose (ii) të paraqesë ndonjë pretendim ose shkak veprimi në lidhje me veprën, që në të dyja rastet konsiderohet në kundërshtim me deklaratën e shprehur të qëllimit të afirmuesit.

4. Kufizimet dhe mohimet

a) Asnjë e drejtë e markës tregtare ose e patentës e mbajtur nga afirmuesi nuk hiqet, braktiset, dorëzohet, licencohet ose preket në formë të tjera nga ky dokument.

b) Afirmuesi ofron veprën ashtu siç është dhe nuk bën asnjë përfaqësim apo garanci të çfarëdo lloji në lidhje me veprën, të shprehur, të nënkuptuar, statutore ose të tjera, duke përfshirë pa kufizim garancitë e titullit, tregtueshmërisë, përshtatshmërisë për një qëllim të caktuar, mosshkeljes ose mungesës së defekteve të fshehura ose të tjera, saktësisë, ose pranisë ose mungesës së gabimeve, qofshin të dallueshme ose jo, të gjitha në masën më të madhe të lejueshme sipas ligjit në fuqi.

c) Afirmuesi heq dorë nga përgjegjësia për pastrimin e të drejtave të personave të tjerë që mund të zbatohen për veprën ose çdo përdorim të saj, duke përfshirë pa kufizim të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me veprën e çdo personi. Gjithashtu, afirmuesi përjashton përgjegjësinë për marrjen e çdo miratimi, leje ose të drejta të tjera të nevojshme për çdo përdorim të veprës.

d) Afirmuesi kupton dhe pranon se Creative Commons nuk është palë e këtij dokumenti dhe nuk ka asnjë detyrë ose detyrim në lidhje me këtë CC0 ose përdorimin e veprës.